

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

DR. MIRZA AJHAN INAK
PSK. SALIM KOSE



Hayrât Neşriyat

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

DR. MIRZA AJHAN INAK
PSK. SALIM KOSE



Duke skanuar kodin QR mund të gjeni përmbajtjet dixhitale dhe të ndani me ne mendimin tuaj rreth librit.

"Faleminderit
paraprakisht"

ISBN: 978-605-193-633-8



Hayrât Neşriyat

Botimi dhe Vëllimi:
**Kompania botuese dhe shtypshkronja
Hayrat Neşriyat, Isparta**
Kuleönü/ Isparta
Tel: 0 (246) 259 46 20
www.hayratnesriyat.com

Të gjitha të drejtat e këtij libri
i përkasin kompanisë dhe shtëpisë
botuese HAYRAT NEŞRIYAT.
Ky libër mund të kopjohet
duke u treguar si burim.

Përgatitur për botim nga:
Yusuf Irmak

Pedagog:
PsK. Salim Köse

Daktilografimi dhe korrek-
tura e gjuhës:
**Akif Atabey
Hüseyin Kurt**

Ilustruar nga:
Z.Oflaz

Organizimi i faqëve:
Ali Parlıtı

Përkthyer nga:
Anxhela Byku

Viti i botimit
Botimi i parë: 2024

PËRMBAJTJA

<i>Entuziazmi për të mësuar gjëra të reja</i>	5
Sa i bukur është besimi!	7
<i>Tre Treguesit e mëdhenj që na tregojnë Allahun</i>	15
A ka gradë imani?	21
<i>Të shohësh mollën? Apo të shohësh prej mollës?</i>	29
Flokbore, s'ka si ti	36
Të shohësh universin në mënyrë holistike	42
Udhëtimi për në universitet	48
Rregulli, është dëshmi e Rregulluesit	51
Univeriteti i Islamit dhe Shkencave	59
Shkenca dhe Islami janë një e tërë	62
Mendja vepron me prova	65
Bota jonë është si një saraj i mrekullueshëm!	69
Gjuha misterioze e krijesave	70
Po të jap mesazhe në gjuhën e veprimeve, a je në dijeni?	72
Një punë që kërkon dije, nuk e bën një i paditur	74
Nuk mund të ketë pikturë pa piktor	76
Subjekti nuk është prej llojit të objektit	79
!Rëtshejm tehdur sërutulf e nimitaziv rëp ehde	81
Çdo gjë është e ndërlidhur me gjithçka!	82
Një i pajetë nuk mund të japi jetë!	83
Nëse në një punë përzihen shumë duar, ajo punë ngatërrohet.	84
I ftuari surprizë	87
Çdo poezi tregon poetin e saj	88
Fakti që engjëjt nuk duken, nuk do të thotë se nuk ekzistojnë	89
Njerëzimi ka nevojë për pejgamberë	92
Do të ketë jetë Ahireti	94
Krijimi për së dyti është më i lehtë se i pari	95
Njerëzit i bëjnë zgjedhjet me vullnetin e tyre të lirë	97
Kur gjithçka e ka një qëllim, si mundet që njeriu të mos ketë!	99
Si mund ta forcoj imanin tim?	107

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



Entuziazmi për të mësuar gjëra të reja

Ato ditët e bukura të pushimeve verore kishin mbaruar dhe shkolla kishte filluar. Nxënësit ishin mësuar me shkollën dhe mezi prisnin të mësonin gjëra të reja. Kështu, me këtë emocion, muaji shtator kishte kaluar sa hap e mbyll sytë; ngjyrat e verdha, të zbehta të tetorit kishin filluar të tregonin praninë e tyre.

Gjethet e pemës së rrapit me trung të gjerë të oborrit të shkollës, në të cilën nxënësit luanin nën hijen e saj në muajt e verës dhe të pranverës, po binin. Degët e trasha të rrapit, në të cilat gjatë verës bënin fole zogjtë, ishin zhveshur dhe gjethet e pemës së stërmadhe endeshin duke fluturuar.

Ky ishte oborri i një shkolle historike, të trashëguar nga koha e osmanëve dhe të ndërtuar pranë Yskodarit në vitin 1898.

Këtë shkollë e kishte ndërtuar Sulltan Abdylhamid Hani, që u kushtonte shumë rëndësi arsimit dhe të rinjve. Godina, që në ata vite ishte planifikuar për t'u bërë shkollë 9-vjeçare, ishte ndërtuar nga gurë të prerë; ishte e gjerë dhe e ndritshme. Për gjerësinë e mjedisit, klasat ishin bërë të larta; dritaret ishin

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

projektuar të gjera, për të pasur dritë dhe oksigjen. Porta kryesore e ndërtesës ishte shumë e madhe. Ajo kishte veçori artistike dhe estetike.

Përballë shkollës ndodhej një librari e madhe. Kjo librari, ishte një dyqan njëkatësh, ku shiteshin mjete shkollore, revista dhe libra. Ky dyqan, që përpara kishte pemë dhe lulishte, ishte mjaft i gjerë. Në bankat që ndodheshin brenda mund të pihej çaj ndërkohë që lexohej libër. Pas mësimit këtu mbushej me nxënës. Këtu nxënësit, mund të plotësonin një pjesë të nevojave të shkollës, si dhe të gjenin librat që dëshironin të lexonin. Pronari i librarisë ishte një mësues në pension, të cilit i pëlqente shumë leximi. Fëmijët e thërrisnin xhaxhi Omeri dhe kur shkonin atje, në shumicën e rasteve, e gjenin atë duke lexuar në tryezë, me syzet e tij të këndshme. Ata bisedonin me të dhe e pyesnin për librat që kërkonin. Xhaxhi Omeri i ndihmonte me kënaqësi.

Në murin e dyqanit shkruhej me shkronja të mëdha: “MERRE, LEXOJE, KTHEJE”. Nxënësit që vinin për herë të parë këtu, habiteshin, pyesnin veten: “Vallë çfarë kuptimi ka?” Pasi mësonin kuptimin e këtij shkrimi, gëzoheshin, sepse me shumë pak të holla, mund të përfitonin prej këtyre librave. Nëse nxënësit do të kishin dëshirë, mund ta merrnin hua nga xhaxhi Omeri librin që u pëlqente për pesëmbëdhjetë ditë, pa e blerë.

Për më tepër, xhaxhi Omeri ishte gjyshi i Ali Xhanit, nxënësi i shkollës 9-vjeçare. Ali Xhani ishte një nxënës i shkathët, gjithmonë i buzëqeshur dhe shakaxhi. Në pushimin e drekës Ali Xhani vinte në librari me shokët e tij, ndonjëherë ndihmonte gjyshin, por më së shumti ulej në tavolinë dhe bëhej pjesë e bisedës së ëmbël të tij.

E, meqë ra fjala, nuk duhet të harrojmë macen e lezetshme të xhaxhi Omerit, Flokëborën. Ajo gjithashtu ishte bërë një me

TË SHOHESH PREJ MOLLËS




dyqanin. Ata që vinin në librari kishin dëshirë të shihnin edhe macen, merakoseshin për të nëse nuk e shihnin. Flokbora ishte një mace akull e bardhë, që i afrohej atyre që vinin për ta ledhatuar. Me mjaullimat e saj të ëmbla, i bënte ata për vete.

Edhe mësuesi i lëndës së kulturës fetare dhe të edukatës morale, zoti Jusuf, ndalonte shpesh këtu për të biseduar me xhaxhi Omerin.

Sa i bukur është besimi!

Ishte ditë e hënë. Nxënësit po zhvillonin lëndën e kulturës fetare dhe të edukatës morale në mësimin e fundit. Ata ndienin lodhjen e ditës, por mësimi i tyre i preferuar kishte nisur. Mësues Jusufi ishte një nga mësues që nxënësit donin

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



më shumë në shkollë. Ajo çka nxënësit pëlqenin më shumë tek mësuesit e tyre, ishte vlerësimi që u jepnin. Ai u jepte rëndësi mendimeve të tyre; u bënë atyre pyetje dhe nuk përgjigjej menjëherë, priste pak sepse donte që ata të mendoheshin. Mendohej t'u ndihmonte për të gjetur përgjigjen. Krijonte komunikim efektiv me nxënësit dhe mësimin e shpjegonte me shembuj nga jeta e përditshme. Në mësim shpjegonte universin dhe ndante me nxënësit bukuritë, artin, mirësitë dhe mrekullitë e krijuara nga Allahu. I bënë edhe ata pjesë të mësimin dhe e zhvillonin së bashku. Madje ndonjëherë i nxirrte nxënësit në oborr dhe e bënë mësimin në ajër të hapur.

Edhe nxënësit e donin shumë mësuesin e tyre, aktivizoheshin në mësim, bënë pyetje dhe shpesh nuk donin që mësimi të mbaronte. Por, zoti Jusuf e përfundonte mësimin pasi zilja binte, duke thënë me buzëqeshje: “Keni nevojë edhe

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

për pushim fëmijë, duhet të përgatiteni edhe për mësimin e radhës.” Ai ndahej nga klasa duke thënë: “Hajt pra, pjesën tjetër të temës do ta zhvillojmë në mësimin e ardhshëm, inshallah. Allahu ju ruajttë!”

Sërish, ishte një nga orët e mësimin të zotit Jusuf. Tema e ditës ishte: “Besimi në Allah.” Zoti Jusuf tha:

- Nxënës, dua të flasim pak për njerëzit para se të flasim për besimin. Njeriu është shumë ndryshe nga krijesat e tjera, edhe ju jeni në dijeni për këtë. Ne si njerëz, mendojmë, jemi kureshtarë, bëjmë pyetje. Ne i studiojmë ngjarjet që ndodhin përreth nesh dhe kërkojmë të zbulojmë shkakun e tyre. As pema dhe as zogjtë që qëndrojnë mbi të, nuk janë kureshtarë të dinë se si shndërrohet një bërthamë e vogël në pemë. Ndërsa njeriu është kureshtar, do të dijë si ndodh kjo dhe e vëzhgon atë me admirim.

Të dashur nxënës, njeriu që kur vjen në këtë botë është i pajisur me aftësi të mjaftueshme. Ai lind me veçori eprore ndaj gjallesave të tjera, si: logjika, kureshtja, habia, dashuria. Fakti që njeriu, me këto aftësi superiore dhe me mënyrën e krijimit, është krijuar ndryshe nga kafshët, është një provë që vërteton se njeriu është dërguar në këtë botë për qëllime të rëndësishme. Kështu, qëllimi më i madh është besimi në Allahun. Mësuesi, duke dashur që nxënësit të aktivizohen në mësim, tha: “Tani le të flasim për pyetjen: Çfarë është besimi?” Ai kërkoi mendimin e tyre për përkufizimin e besimit.

Nesibja:

-Të besosh, mësues.

- Bukur, u përgjigj zoti Jusuf.

Ali Xhani:

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Të besosh me zemër dhe me sinqeritet.

- E drejtë, po ecim mirë, - ia ktheu zoti Jusuf.

Betyli, nxënësja që lexonte më shumë libra në atë klasë, tha:

-Mësues, në një libër shkruhej: “Të besosh pa pasur asnjë dyshim tek Allahu.”

Zoti Jusuf:

- Shumë mirë.

Mustafa ngriti dorën:

-Çështja e besimit ka ekzistuar që me njeriun e parë, apo jo mësues?

-Po, Mustafa, çështja e besimit ka ekzistuar që me njeriun e parë. Ademi (a.s.), është njeriu i parë dhe në të njëjtën kohë është edhe peygamberi i parë. Njerëzit e mësojnë besimin me anë të peygamberëve. Peygamberët na mësojnë se si duhet të jetë besimi, ashtu siç na mësojnë se çfarë është ai. Përgjigjet bindëse te pyetjeve, si: “Cili është kuptimi i njeriut? Çfarë kuptimi ka bota? Përse jemi dërguar në këtë botë? Cila është detyra që kemi këtu? Ku do të shkojmë pas kësaj bote?”, për të cilat janë kureshtarë të gjithë, mund t’i mësojmë vetëm nëpërmjet peygamberëve.

Rejani, duke marrë fjalën, pyeti:

-Mësues, si besojmë? A besojmë vetëm duke e ndier?

Zoti Jusuf, i kënaqur nga vëmendja dhe interesi që nxënësit kishin për mësimin, thotë:

- Ke bërë një pyetje të rëndësishme, Rejan. Besojmë me zemër, por shprehemi me gjuhë. Zemra është qendra

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

shpirtërore, ku besimi lëshon rrënjë dhe zë vend. Ndërsa gjuha, është një mjet që tregon besimin që është në zemër. Zemra, ku është vendosur besimi, ka një strukturë shpirtërore. Këtë zemër, nuk duhet ta ngatërrojmë me organin, në madhësi sa grushti i gjithsecilit, që i pompon gjak trupit tonë.

Ju i shprehët shumë bukur pikëpamjet dhe veçoritë e ndryshme të besimit. Atëherë, unë po i përmbledh ato që ju thatë: *“Të besosh, do të thotë të pranosh dhe të besosh me zemër ato që Pejgamberi (a.s.) jonë i dashur ka sjellë nga Allahu.”* Njeriu, besimin e miraton me zemër dhe e shpreh me gjuhë.

Të gjithë pejgamberët, me urdhrin që merrnin nga Allahu, u kanë mësuar njerëzve të besojnë në ekzistencën dhe vetminë e Allahut. Gjithashtu, Pejgamberi (a.s.) jonë i dashur na ka mësuar ekzistencën, vetminë e Allahut, si dhe që nuk ka shok e as ndihmës. Këtë e quajmë besimi në Teuhid. Islami është fe e teuhidit.

Hasani:

-Çfarë është teuhidi, mësues? A mund të na e shpjegoni pak?

-Teuhid, do të thotë ta shohësh Allahun unik. Pra, të pranosh vetminë e Allahut dhe ta besosh atë. Teuhidi është një bazi shumë e rëndësishme në fenë tonë. Ai që hyn në Islam duhet ta thotë me zemër dhe me sinqeritet fjalinë që dëshmon teuhidin, pra: *“La ilahe illallah Muhammedun Rasulullah”*. Në gjysmën e parë të kësaj fjale shprehim se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, ndërsa në gjysmën e dytë shprehim se Muhammedi (a.s.) është i dërguari i Tij. Njeriu, pa e thënë ketë fjalë në këtë mënyrë, nuk konsiderohet se ka besuar.

Ahmeti kërkoi fjalën:

-A mund t’ju tregoj një ngjarje në lidhje me këtë temë,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



që më ndodhi fundjavën e kaluar?

-Urdhëro Ahmet!

-Në fundjavë pata shkuar me familjen tek xhamia Aja Sofia, mësues. U ndesha me një ngjarje interesante në atë xhami të mrekullueshme. Një turist i ri gjerman me emrin Fredy, kishte hulumtuar për Islamin dhe kishte vendosur të bëhej mysliman. Ai kishte ardhur te imami i xhamisë Aja Sofia bashkë me të njohurit e tij te huaj, me të cilët ishin fqinj në qytetin Hamburg të Gjermanisë. Mes njerëzve të grumbulluar, pranë mihrabit, pra altarit, ku imami drejtonte namazin, u bëra dëshmitar i hapit të tij të parë drejt Islamit.

Ali Xhani:

-Uaa, sikur të isha edhe unë aty. Vërtet interesante.

Mësues Jusufi:

-A mund të na tregosh edhe pak? Si ndodhi?

-Fillimisht imami e përgëzoi të riun, mësues. Shokët myslimanë pranë të riut, përkthenin fjalët e tij dhe të i mamit, në mënyrë reciproke. Më pas, imami po fliste për mirësitë e Islamit dhe e pyeti të riun për arsyen pse kishte zgjedhur Islamin. Gjermani i ri, duke treguar shokët pranë tij, tha: "Arsyeja më e madhe janë fqinjët e mi dhe shokët myslimanë që kam në shkollë. Mënyra e tyre e jetesës, struktura e familjes, humanizmi, fqinjësia, mëshira dhe drejtësia e tyre më kanë

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

bërë shumë përshtypje. Më pas fillova të hulumtoj për fenë e tyre. Sa më shumë të hulumtoja për Islamin, Muhammedin (a.s.), Kuranin, aq më shumë më pëlqeu, kur më pëlqente hulumtoja edhe me më shumë kureshtje. Për këtë qëllim erdha të vizitoj edhe Turqinë. Gjithashtu, ezanet dhe xhamitë në Stamboll kanë ndikuar shumë tek unë dhe sot vendosa të bëhem mysliman, fale Zotit.”

Imami pasi e përgëzoi sërish të riun, i shpjegoi atij rëndësinë e Shehadetit dhe i tha ta përsëriste edhe ai me ata. Edhe ne që ndodheshim atje e shqiptuam shehadetin. Thamë: *“Esh-hedu en la ilahe illallah ue esh-hedu enne Muhammeden abduhu ue rasuluhu.”* Po mësuës, vërtet u preka shumë. Më pas të gjithë ata që ndodheshin aty, e përqaftuan dhe e përgëzuan të riun, tashmë mysliman. Ende i kam në mendje lotët e gëzimit që i rridhnin të riut turist.

Zoti Jusuf:

-Paskeni përjetuar vërtet një ngjarje emocionuese. Falënderimi i takon Allahut, një tjetër vëlla qenka nderuar me Islamin. Sa bukur!

Javuzi:

-Ç’do të thotë të nderohesh me Islam, mësuës?

Zoti Jusuf:

-Po, një pyetje kuptimplotë. Të dashur nxënës, është detyra jonë e parë ta besojmë dhe ta pranojmë Allahun. Sepse, ky është qëllimi kryesor për të cilin jemi dërguar në këtë botë. Zoti i Plotfuqishëm e ka krijuar universin, që ne të prezantohemi, ta njohim dhe ta duam Atë. Të gjitha pejgamberët i ka dërguar që t’i ftojnë njerëzit të besojnë.

Kështu njeriu, me fjalën e Shehadetit, prezantohet me të

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

vërtetën më të madhe, që është besimi. E pranon Allahun dhe i dorëzohet Atij. E di që çdo gjë vjen prej Tij. Me iman ai kupton që çdo të mirë si: dora, gjuha, syri, mendja, zemra, nëna, babai, atdheu vjen nga Krijuesi i tij, nga Allahu. Kështu që, mes tij dhe Krijuesit krijohet lidhja e besimit. Kjo lidhje besimi është vlera më nderuese dhe më prestigjioze që kemi. Në Islam nderi nuk bëhet me prejardhje, pozicion apo me pasuri. Nderi i vërtetë në myslimanizëm është imani dhe Islami. Kështu Fredy, u nderua me një nder të tillë.

-Aaa, mësues, për pak sa nuk e harrova. Fredy, tha se donte të ndyshonte emrin, kur u bë mysliman. Imami i tha: “Ti e di, mund ta ndryshosh.” dhe i tregoi që: “Shekuj më parë Isai (a.s.) ka lajmëruar për ardhjen e Muhammedit (a.s.) dhe emri i tij i përmendur në Ungjill ishte Ahmet.” Ai i propozoi këtë emër Fredyt. Ndërsa Fredy e pranoi me kënaqësi.

Zoti Jusuf:

-Pse s’thua ti Ahmet, qenke bërë edhe bashkëfetar edhe adash me vëllanë tonë mysliman.

-Po mësues, ishte një ditë shumë e bukur, që nuk do ta harroj gjithë jetën. Tani sa herë më vjen ndër mend xhamia Aja Sofia, më kujtohet edhe adashi im Ahmet, që sapo është bërë mysliman.

Zoti Jusuf, iu drejtua klasës:

-E falënderoj shokun tuaj Ahmet. Ndau me ne një ngjarje



**Besimi
e bën
njeriun
njeri
të vërtetë**

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

që na preku të gjithëve. Duke e përjetuar, na tregoi neve se sa i bukur është besimi. Nxënës të dashur, imani është si dielli. Ai e ndriçon një njeri të mbetur në errësirë, si brenda edhe jashtë. Njeriu, falë imanit, bëhet njeri i vërtetë duke u përsosur me moralin e mirë që Pejgamberi ynë (a.s.) na ka mësuar si shembull. Ai mëson se ç'janë humanizmi, mëshira, pastërtia, sakrifica, mirënjohja, morali, edukata dhe i jeton këto. Ja pra, e patë! Si i prekin njerëzit e tjerë, njerëzit e mirë që praktikojnë Islamin në shtetet e huaja. Ata u afrojnë zemrën tek Islami edhe të tjerëve. Mendoj se duhet të përgëzojmë edhe fqinjët dhe shokët mërgimtarë myslimanë të djaloshit gjerman. Sepse bukuria dhe vërtetësia e Islamit që ata jetonin u pasqyrua në zemrat e njerëzve.



Nesibja kërkoi fjalën:

-A ka imani lloje dhe gradë, mësues?

E gjithë klasa, me sy kureshtarë dhe në qetësi, po priste përgjigjen e kësaj pyetjeje. Mu në atë kohë ra zilja për pushim dhe zoti Jusuf e mbylli mësimin duke thënë: “Nxënës, nëse dëshironi, le t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje në mësimin e ditës së mërkurë.”

Tre Treguesit e mëdhenj që na tregojnë Allahun


Nxënësit morën çantat dhe dolën me ngadalë nga klasa. Katër-pesë nxënës, u drejtuan drejt librarisë përballë shkollës, duke biseduar me njëri-tjetrin. Kur u futën brenda, xhaxhi

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



Omerin e gjetën duke lexuar libër mbi tavolinë, sërish. Aty ndodhej edhe Flokëbora, me ëmbëlsinë e zakonshme. Xhaxhi Omeri i priti me buzëqeshje duke iu thënë: “Mirë se erdhët fëmijë!” Në vazon me ngjyrë mbi tavolinën e xhaxhi Omerit kishte lule me aromë shumë të mirë. Ali Xhani, kur do t’i kërkonte leje gjyshit për t’i marrë erë lules, gabimisht goditi vazon. Për një moment vazoja u shemb në tavolinë. Nuk u thye, por Flokëbora u hodh në prehrin e xhaxhi Omerit duke mjaullitur, nga zhurma e shkaktuar. Për një moment vendi u gjallërua. Të gjithë po shikonin Ali Xhanin. Kur edhe Ali Xhani po shihte gjyshin e tij me habi, të gjithë fëmijët qeshën. Ali Xhani me fytyrën e buzëqeshur të përhershme: -“O gjyshi, më fal, papritur mu pengua këmba.” Xhaxhi Omeri, me një ton zëri të mirëkuptueshëm tha: “Gjëra të tilla ndodhin Ali Xhan, ska problem. Njerëz jemi të gjithë. Patjetër që kemi disa gabime. Njerëzillëku, është i rëndësishëm. Respekti dhe dashuria për njëri-tjetrin. Myslimani duhet për gjuhën e ëmbël, fytyrën e buzëqeshur dhe mirëkuptimin që ka. “Kush kërkon mik pa gabime, ngelet pa mik” -kanë thënë të parët tanë.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



Po, fëmijë si jeni, mirë? Më dukeni mirë, mashallah. Si shkojnë mësimet?

Hasani:

-Mirë shkojnë, shyqyr Zotit xhaxhi Omer. Në orën e fundit zhvilluam temën: “Besimi në Allah”. Kur kuptuam rëndësinë e besimit thamë: “Çfarë librash mund të lexojmë për këtë temë?” dhe bashkë me shokët erdhëm këtu.

Xhaxhi Omeri:

-Fëmijë, fillimisht ju përgëzoj. Kam dëshirë t’ju ndihmoj. Një njeri që e ka kuptuar rëndësinë e imanit dhe është në dijeni për të, është kureshtar edhe për mënyrën se si ta forcojë imanin. Qëllimi më i madh i krijimit tonë është besimi në Allah dhe adhurimi i Tij. Vërtet duhet ta forcojmë imanin tonë. Janë tre tregues të mëdhenj që na njohin me Zotin tonë. Më së pari, duhet të njohim dhe të mësojmë ata.

Ibrahimi:

-Cilët janë ata tregues xhaxhi Omer?

-Tre treguesit që na njohin me Zotin tonë janë: i pari, libri i universit, i dyti, Pejgamberi (a.s.) dhe i treti Kurani Famëlartë.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Universi, me çdo gjë brenda tij, është si libër që na bën ta njohim dhe ta duam Zotin tonë. Kështu, ne duhet ta lexojmë dhe ta studiojmë librin e universit. Ne duhet ta shohim si shembull dhe duke nxjerrë mësim çdo gjë në univers, ashtu siç Allahu na ka treguar në Kuran dhe siç Pejgamberi (a.s.) ynë i dashur na ka mësuar me jetesën e tij. Këtij veprimi, të menduarit tërësor, i themi “tefekkur”, meditim. Keni dëshirë t’ju tregoj një nga shembujt e tefekkurit, për të cilin flitet në Kuran?

-Fëmijët të gjithë së bashku thanë: “Poooo”.

Ibrahimi:

-Xhaxhi Omer, nëse është e mundur shembulli i tefekkurit, a mund të jetë në lidhje me jetën e ndonjë prej pejgamberëve?

Ndërkohë punonjësit e librarisë, që vunë re se biseda u thellua, kishin sjellë çaj të freskët dhe fruta të thata në tavolinë. Xhaxhi Omeri duke i falënderuar punonjësit, iu kërkoi që më parë t’ua jepnin çajin djelmohave, që do të ishin të mëdhenjtë e së ardhmes. Më pas, e vazhdoi fjalimin kështu:

-Në rregull, pse jo Ibrahim! Si fillim, hani nga frutat e thata që shoqërojnë këtë çaj të freskët. Shembulli jonë është në lidhje me një ngjarje që ka përjetuar Ibrahim (a.s.). Mustafai, duke u kthyer nga Ibrahim tha pa zë: “Shiko Ibrahim, një ngjarje në lidhje me emrin tënd.” Xhaxhi Omeri me një ton zëri të mëshirshëm: Fëmijë të çmuar, Ibrahim (a.s.) ishte i ri, si ju. Në kohën që jetonte Ai nuk dihej besimi në Allah. Njerëzit adhuronin idhujt. Ndërsa Ibrahim, po kërkonte Zotin e tij, se i dukej i pa logjikshëm adhurimi i idhujve. Një natë, pa një yll që shkëlqente në qiell. Filloi të mendonte duke thënë: “A mund të jetë ky Zoti im?”. Pak më vonë, kur pa që ai yll perëndoi dhe humbi në qiell, tha: “Unë nuk i dua ata që perëndojnë. Ky yll nuk mund të jetë Zoti im.” Më vonë, pa të shfaqej në

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



qiell hëna duke ndriçuar. Përsëri u zhyt në mendime të thella duke thënë: “Vallë a mund të jetë kjo Zoti im?” Duke menduar erdhi mëngjesi dhe pa që edhe ajo perëndon, humbet. Tha që: “Edhe hëna nuk mund të jetë Zoti im.” dhe iu Lut Zotit të Plotfuqishëm: “O Zot, nëse ti nuk ma tregon rrugën e drejtë, unë nuk mund ta gjej.”

Ali Xhani me entuziazëm:

-Gjyshi si ndodhi, a e gjeti dot Allahun Ibrahim (a.s.) pas lutjes?

Khaxhi Omeri:

-Po, Ali Khan, je shumë i shpejtë, fiks atë do thosha edhe unë tani. Pra, kur erdhi mëngjesi dhe dielli lindi me gjithë ndriçimin e tij, Ibrahim (a.s.) mendoi: “Dielli është shumë i madh. Vallë, a mund të jetë ai Zoti im?” Më vonë kur pa që edhe ai perëndon në mbrëmje, kuptoi që krijuesi suprem duhet të ketë veçori si: të mos perëndojë, të mos ketë fund, të mos humbasë, të mos zhduket. Dhe e gjeti Allahun duke thënë: “Unë iu drejtova Allahut që ka krijuar qiellin dhe tokën.”

Mustafai:

-Sa bukur, Ibrahim (a.s.) është munduar të gjejë Allahun duke lexuar librin e universit. Ai me këtë tefekkur, na ka mësuar neve se çfarë veçorish duhet të ketë një Zot.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Ali Xhani:

-Gjyshi, në botë ka edhe njerëz që nuk e besojnë ekzistencën e Allahut. Si do ta vlerësojmë këtë?

-Po, edhe kjo është një pyetje e bukur. Fëmijë, të gjithë ne jemi në sprovë. Zoti neve na ka dhënë liri të besojmë ose jo. Ka ndodhur që të gjejmë Allahun duke parë veprat e Tij, ashtu si Ibrahim (a.s.) dhe pasuesit e tij. Por, ka ndodhur edhe të mos e pranojmë Allahun, me justifikime të ndryshme. Zoti ynë i ka dhënë njeriut mendje dhe jetëgjatësi, për një kohë te caktuar. Ai i ka ofruar njeriut veprat e Tij të pafundme, të mirat dhe dhuratat e pafundme. E ka lënë njeriun vetëm për vetëm me vullnetin e tij të lirë. Një njeri duke e vlerësuar me mendjen dhe ndërgjegjien e tij, e di se as edhe një gjilpërë qepëse nuk bëhet dot vetvetiu. Edhe një gjilpërë e ka një usta, një krijues.

Fëmijë, ne nuk themi se Allahu ekziston vetëm se ashtu besojnë të gjithë. Themi se Allahu ekziston se vërtet Ai ekziston. Dhe këtë e vërtetojmë. Ne besojmë në ekzistencë e Allahut me prova. Të vërtetosh ekzistencën e një gjëje që ekziston është shumë e thjeshtë.

Mustafai pak i habitur tha:

-Nuk e kuptova mirë, Xhaxhi Omer. Xhaxhi Omeri nxorri një fjalor termash nga rafti ngjitur dhe ia zgjati Mustafait. -Mustafa, a mund ta gjesh në këtë fjalor termin "Allah"?

Mustafai menjëherë gjeti termin "Allah" tek shkronja "A" dhe tha: "E gjeta xhaxhi Omer. Në faqen e tetë. "Xhaxhi Omeri:

-E shikon pra, ti e gjete me lehtësi termin "Allah" sepse ai gjendet në fjalor. Tani, në të njëjtin fjalor, mundohu të na vërtetosh se, termi "Allah" nuk gjendet.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Mustafai:

-O xhaxhi Omer, po kjo është shumë e vështirë. Për këtë, duhet të tregoj që në asnjë prej faqeve nuk gjendet ai term.

-Po fëmijë, të vërtetosh ekzistencën e një gjëje që ekziston është e thjeshtë, por të vërtetosh mungesën e saj është e vështirë.

Ne myslimanët, e vërtetojmë me lehtësi ekzistencën e Allahut, ndërsa mosbesuesit nuk e vërtetojnë dot mungesën e Tij.

Xhaxhi Omeri i nxorri fëmijët drejt derës së dyqanit. Duke parë rrezet që pasqyron dielli nga jashtë tha: -A humbet dielli nëse disa njerëz i mbyllin sytë ndaj tij, fëmijë? Fëmijët:

-Jo, vetëm ata persona nuk e shikojnë dielli, ai gjithsesi ekziston.

Xhaxhi Omeri, duke u kthyer nga Ali Xhani tha: “Kështu pra Ali Xhan, mosbesuesit i mbyllin sytë ndaj Allahut, ekzistenca e të cilit është e qartë si dielli.”

A ka gradë imani?

Ishte ditë e mërkurë. Përsëri ishte ora e mësimit të zotit Jusuf. Zoti Jusuf, si gjithmonë, pyeti nxënësit se si shikojnë gjërat. Më pas, iu drejtua Nesibes, që bëri pyetje mësimin e kaluar: “Nesibe, mësimin e kaluar bëre një pyetje. Nuk u përgjigja dot sepse ra zilja. Nëse dëshiron rikujtoja pyetjen klasës.”



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Mësues, pyeta nëse besimi ka lloje dhe gradë.

Zoti Jusuf e nxori të gjithë klasën në oborr, duke thënë: "Koha është me diell, nëse dëshironi, le t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje ulur nën pemën e rrapit." Ishin në muajin tetor, por po përjetoreshin ditë vere. U ulën në pjergull dhe filluan të flisnin. Fëmijët i priste një surprizë në pjergull. Në një tepsi të bukur, ndodheshin rreth njëzet mollë të kuqe, të mëdha e të pjekura.

Zoti Jusuf:


-Në fillim, të hamë mollët pastaj flasim për llojet e imanit, si rrjedhojë e gradës së tij.

Sait i dashur, i pata larë mollët. A mund t'ua ndash shokëve? Saiti kujdestar, e mori tepsinë dhe ua zgjati shokëve. Të gjithë morën nga një.

Mësues Jusufi:

-Hë, filloni fëmijë, Bismil-lah.


Filluan t'i hanë mollët. Të gjithë po e falënderonin mësuesin e tyre. Sidomos Ali Xhani: "Mollët qenkan vërtet shumë të shijshme, mësues."-tha.



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Zoti Jusuf duke ngrënë mollën:

-Ju bëftë mirë fëmijë. Zoti ynë na i ka dërguar neve këto mollë si bekim. Falënderimin e vërtetë ia shprehim Atij. Vetëm se, kam një kërkesë për ju, kur të mbaroni mollët mos i hidhni bërthamat, ruajini.



Kur mbaruan mollët u rikthyen në mësim. Zoti Jusuf i nxori pesë-gjashtë bërthamat e mollës së tij. U tha që t'i nxirrnin edhe ata. Në pëllëmbën e secilit gjendeshin bërthama me ngjyrë të errët.

Fëmijë po flasim për gradët e ndryshme të imanit. Këto bërthamë mund të jenë udhëzues për ne në këtë aspekt. Le të mendojmë kështu. Nëse njërën prej bërthamave që kemi në dorë e hedhim në tokë, duke ruajtur kushtet e nevojshme, fillimisht bërthama mbin mbi tokë. Pas një kohe bëhet filiz dhe më pas fidan. Pasi të rritet edhe pak, forcohet. Më në fund, bëhet një pemë e madhe molle që ka fruta dhe hije. Në fakt, të gjitha këto gradë janë një fazë e pemës së mollës.

Nxënës të çmuar, aq sa gradë dhe shkallë ka mes bërthamës së mollës dhe pemës së mollës, aq gradë dhe shkallë ka edhe në iman. Njeriu mund ta përmirësojë dhe ta forcojë imanin duke u përpjekur për këtë. E dashur Nesibe, dua të të bëj një pyetje. A është më e vështirë të shkulësh nga toka një fidan

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

molle të hollë, apo një pemë molle që ka zënë vend e është ngulitur në tokë?

-Patjetër që të shkulësh një pemë molle nga vendi i saj është më e vështirë, mësues.

-Saktë. Nuk është fare e lehtë të shkulësh një pemë të kultivuar, të zhvilluar, ngaqë rrënjët e saj janë lëshuar në thellësi të tokës. Kështu, edhe imani kur forcohet, zë vend deri në thellësitë e strukturës shpirtërore të njeriut. Fiksohet për të mos u shkulur. Të mendojmë edhe këtë pemën e rrapit, që jemi ulur nën të. Rrënjët e saj janë shpërndarë gjithandej. Një pemë e tillë, a shkulet dot me lehtësi nga vendi i saj?

Mustafai:

-Mësues, imani ndahet në lloje sipas gradëve të zhvillimit?

-Po, ashtu është. Imani, ndahet në dy lloje sipas gradës së zhvillimit. Në themel, imani ndahet në dy lloje: i dobët dhe i fortë. Po përpiqem t'ua shpjegoj me një shembull, për të kuptuar më mirë imanin që është i dobët dhe atë që është i fortë. Fëmijë të çmuar, nëse në një treg do të vinin mallra të ndryshëm të një personi të pasur, ne mund ta kuptojmë në dy mënyra që këto mallra janë të atij personi. Njëra mënyrë është një shikim sipërfaqësor... Të mendosh duke thënë: "Kaq shumë mallra, vetëm të atij të pasurit mund të jenë. Kaq mallra nuk mund të jenë të askujt përveç atij personi." është mendim sipërfaqësor.


Javuzi:

-Por, mësues, a nuk është një pikëpamje përgjithësuese kjo?

-E drejtë. Ky këndvështrim, është vetëm nga pamja e jashtme dhe jep vendimin duke e përgjithësuar. Sepse nëse dikush do ti thoshte këtij personi, që mendon kështu, se: "Mallrat që sheh ti nuk janë të atij personi, por janë të filanit.",

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

ose “Një pjesë e atyre mallrave genka e dikujt tjetër.”, menjëherë do të vihej në dyshim dhe do të thoshte: “Mundet.” Sepse nuk ka provë në dorë.



Javuzi:

-Atëherë, cila është mënyra e dytë mësues?

-Ndërsa mënyra tjetër është, që të studiosh dhe të kërkosh. Një person që zgjedh këtë mënyrë, vë re emblemën e pronarit mbi çdo mall, sheh logon e atij personi dhe njeh pronarin e atij malli. Në këtë mënyrë e kupton me siguri, që secili prej mallrave i përket atij personi. Në asnjë mënyrë, nuk bie në dyshim duke thënë: “A janë vërtet të atij këto mallra?” Nëse dikush mundohet ta vërë në dyshim, ai i thotë: “Këto mallra dhe çdo gjë që ndodhet këtu, nga më e madhja tek më e vogla, mbartin logon e tij. Këto mallra janë të atij.” dhe e vërteton duke i treguar logon e atij personi.

Nxënës të dashur, kështu edhe imani ndahet në dy lloje, sipas gradëve. I pari, është imani i përvetësuar pa hulumtuar për ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut. Pra, kur njeriu pranon ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut duke parë, dëgjuar dhe duke kopjuar familjen, të afërmit apo shoqërinë. Këtë e quajmë edhe iman të përvetësuar nga një mënyrë kopjuese. Ky iman është i dobët. Një njeri me iman të tillë thotë: “Allahu ekziston dhe është një.” dhe nuk e ndjen të nevojshme të hulumtojë, thjesht e pranon ashtu. Një njeri me iman të tillë e ka të lehtë të vihet në dyshime.

Ibrahimi ngriti dorën:

-Mësues, me këtë lloj imani, a mund ta vërtetojë personi besimin e tij?

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Një pyetje e bukur. Nxënës, për fat të keq duke qenë se në mënyrën e kopjimit nuk ka hulumtim, ai person nuk mund ta vërtetojë që Allahu është Zotëruesi dhe Krijuesi i çdo gjëje. Për këtë, një person i tillë, mund të vihet në dyshim me lehtësi. Po fëmijë, tani e kuptuam imanin e mësuar nga shoqëria, në mënyrë të kopjuar. Atëherë le të mundohemi të gjejmë së bashku veçoritë e imanit që është më i fortë, sipas gradëve.

Kujdestari i klasës, Saiti, duke kërkuar fjalën tha:

-Sipas atyre që shpjeguat, për një iman të fortë duhet të hulumtojme, të pyesim dhe të studiojmë, apo jo?

-Po, shumë e vërtetë.

Betyli:

-Mësues, atëherë me mënyrën e hulumtimit, të pyeturit dhe të studimit arrijmë të gjejmë prova për ekzistencën dhe vetminë e Zotit, apo jo?

Zoti Jusuf:

-Shumë mirë. Filluan të shfaqen veçoritë e imanit të fortë. Po nxënës të dashur, në një iman të fortë fillimisht duhet të ketë hulumtim. Ekzistenca dhe njëshmëria e Allahut arrihet duke kërkuar. Ai që arrin këtë gradë, të imanit të fortë, e di me siguri që Allahu është Zotëruesi i çdo gjëje. Sepse ka prova në dorë. Me këto prova mbështet me vendosmëri që, Allahu është Ai që krijon dhe drejton çdo krijesë. Vë re, shikon dhe studion dëshmitë, që i përkasin Allahut, mbi çdo krijesë. Beson pa dyshuar aspak. Ky person shikon dhe tregon Allahun në çdo gjë që sheh. Një njeri që ka arritur këtë gradë imani, nuk bie në dyshim sepse ka një besim të pa lëkundshëm. Një iman i tillë, duke u forcuar zë vend dhe lëshon rrënjë në zemrën e njeriut. Është shumë e vështirë që ai të lëkundet.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Elifi, që është nga më të urtat e klasës:


-A mund ta shtjelloni edhe pak vendosjen e imanit në zemrat tona, mësues? Çfarë shembujsh mund të japim kur ia shpjegojmë dikujt tjetër këtë temë?

Ali Xhani:

-Po mësues, edhe unë jam kureshtar për pyetjen e Elifit. Të kemi iman të fortë, të lëshojë rrënjë brenda nesh dhe të mos ndahet kurrë nga ne. Të mos biem në dyshime.

Zoti Jusuf:

-E thatë shumë bukur. Mendimi për t'iu ardhur në ndihmë edhe të tjerëve në këtë temë është një qasje e bukur. Le të mendojmë kështu, nxënës: Imani është si ushqim shpirtëror, për të cilin zemra jonë ka nevojë. Të mendojmë mollën në këtë tepsi! Elif merre në dorë një. Tani, a mund të ta marri dikush me dhunë nga dora, në mënyra të ndryshme?



Elifi:

-Po mësues, duke përdorur dhunën mund të ma marri.

Zoti Jusuf:

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-E vërtetë. Kjo është e mundur. Mirë tani, nëse ti e ha, e tret dhe molla të përzihet me gjakun tënd e të shpërndahet në qelizat e tua, tashmë a mund të ta marri më njeri atë mollë?

Elif:

-Jo, s'mund ta marri mësues! Tanimë askush nuk mund të ma marri atë mollë që treta dhe që është një pjesë e imja.

Zoti Jusuf:

-Ja pra, edhe imani i fortë kështu është. Një iman i fortë zë vend deri në thellësitë e zemrës. Ai lëshon rrënjë dhe zhvillohet aty, si një pemë rrap. Askush nuk mund ta marri prej tij, një iman të fortë, të cilit njeriu i ka mësuar dëshmitë dhe që e jeton me çdo ndjenjë të tij.

Ali Xhani, të cilit i pëlqen shumë shembulli i dhënë, i entuziazmuar thotë:

-Po mësues, një iman të tillë askush nuk mund ta shkuli e ta marri nga zemra jonë.


Saiti, me një ton zëri të vendosur:

-Mësues, tani e kuptova më mirë se, pse disa njerëz bien në dyshim, në aspektin e besimit. Kur e kemi imanin të dobët ndikohemi menjëherë. Atëherë, edhe unë duket të përpiqem ta forcoj edhe më shumë imanin tim. "-tha.

Zoti Jusuf, duke i aprovuar me lëvizje të kokës ato që tha Saiti:

-Të dashur nxënës, një njeri me iman të forte kudo që sheh arrin të dallojë ekzistencën dhe vetminë e Allahut. Për shembull, le të shohim shkollën përballë nesh! Ka kaluar më shumë se një shekull, që nga ndërtimi i saj. Ne nuk jemi njohur e as nuk e kemi parë inxhinierin që ka bërë këtë godinë. Por,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



jemi një qind për qind të sigurt për ekzistencën e një inxhinieri, që ka projektuar dhe ndërtuar këtë godinë, apo jo?

Fëmijët:

-Patjetër mësues. Si mund të bëhet vetvetiu kjo godinë e bukur?

-Keni të drejtë fëmijë. Gurët e prerë të kësaj godine

nuk mund të bashkohen duke ndërtuar këtë godinë vetvetiu. Këtë godinë të bukur e të gjerë, e ka bërë një njeri, ndryshe nga lloji i godinës, që i njuh njerëzit dhe që e dinte se në të do të jetonin njerëz. Me dijen e tij, në një plan, në fillim ka bërë themelin, më pas muret dhe në fund fare çatinë. Sipas veçorive të godinës mund të gjejmë veçoritë e inxhinierit edhe pse nuk e shohim inxhinierin. Mund të kuptojmë anët e ndryshme të tij.

Të shohësh mollën? Apo të shohësh prej mollës?

Mësimi po vazhdonte me gjithë entuziazmin e tij. Saiti, duke kërkuar sërish fjalën:

-Mësues, a mund të bëjmë edhe një tjetër ushtrim logjik, që na çon drejt imanit të fortë?

-Haj, haj! Për shembull; "Le të mendojmë mollën që po hamë!". Një person me iman të fortë duke studiuar mollën, vë re që në mollë ka formë, ngjyrë, aromë dhe shije që i përkasin shijes dhe ndjenjave të njeriut. A nuk e vumë re të gjithë ne

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

këtë, ndërkohë që po hanim mollë? Mollë të mëdha, në dukje të lezetshme, të lëngshme, me aromë, të shijshme... Më pas, njeriu fillon të kërkojë burimin e këtyre veçorive të mollës dhe thotë: “Veçoritë e kësaj molle mund t’i krijojë dikush që e do dhe e njeh njeriun. Për shembull, mollën mund të na e japi dikush që e di nevojën që kemi për vitaminat. Më pas, që të bëhet një mollë, varet nga dheu, uji, klima dhe pema, të cilat i kemi parasys. A janë vërtet këto të aftë të mendojnë dhe të planifikojnë veçoritë që shohim tek një mollë? Pyet: “A kanë një aftësi të tillë këta?” dhe kërkon përgjigje për këtë pyetje. Në përfundim të këtij studimi kupton që, formën e mollës, shijen dhe aromën e mrekullueshme, shijen e mirë të saj nuk i bëjnë dot pema, dheu dhe shkaqet e tjera pa ditur e pa ndjenja.”-tha.

Zoti Jusuf duke ndaluar pak tërhoqi vëmendjet dhe vazhdoi fjalimin:

Nxënës, këtu ka një ndryshim shumë të rëndësishëm këndvështrimi. Të shohësh mollën dhe të shohësh prej mollës janë dy gjëra të ndryshme. Këtu ka dy mënyra këndvështrimi. Nëse ju shihni vetëm mollën, shihni vetëm veçoritë materiale pa menduar bërësin e saj. Flisni për vitaminat e dobishme të mollës. Nuk ju vjen shumë në mendje se kush i ka vënë brenda saj ato vitaminat. Nuk e vini re plotësisht Allahun që krijoi mollën dhe na e dhuroi neve. Ndërsa kur shihni prej mollës, molla bëhet një send. Jeni kureshtarë për autorin që bëri këtë send. Kur shihni nga molla, ajo mollë bëhet një objekt artistik. Kërkoni artistin e atij arti. Pyesni pyetjet: “Kush e ka varur në degë për ne këtë frutë? Kush e ka zbukuruar brenda dhe jashtë sipas ndjenjave tona? Kush e ka mbushur mollën me vitamina shëruese, e të dobishme, për të cilat kemi nevojë?” dhe kërkoni kryefjalën e foljeve të mollës. Me këtë këndvështrim kuptoni që formën e bukur të mollës, aromën e

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

mrekullueshme dhe shijen e mirë të saj mund t'i bëjë Allahu që na njeh dhe na mëshiron. Me këtë këndvështrim nuk thoni "Sa e bukur është molla!", por thoni "Sa bukur është bërë molla, sa bukur është krijuar për ne!" Në këtë mënyrë e kuptoni që, bukuria dhe dobishmëria e mollës nuk vijnë nga toka, uji dhe klima, por nga zotëruesi i vërtetë, Allahu. Dhe më pas arrini në ekzistencën e Krijuesit tonë të Mëshirshëm, Bujar, të Plotfuqishëm dhe të Gjithëdijshtëm.

Ali Xhani me gëzimin e të mësuarit diçka të re:

-Mësues, a mund të tregoj diçka në lidhje me këtë? Mendoj se do të kishte dobi në mësim...

Zoti Jusuf duke tundur kokën:

-Urdhëro Ali Khan!

-Mami im, në fundjavë kishte bërë një tortë shumë të mirë për motrën time, një vit më të vogël se unë. Kishin ardhur edhe gjyshërit tek ne. Torta ishte e shijshme, brenda me çokollatë, jashtë e mbuluar me krem dhe sipër e zbukuruar me luleshtrydhe.

Mustafai:

-Ali Khan mos të lutem! Po e përshkruan në një mënyrë që më lëshon goja lëng.

-Të më falni shokë, keni të drejtë por kështu duhet ta tregoj. Mami im ishte munduar goxha mes gjithë atyre punëve. Kur sa do ta hanim tortën gjyshi tha: "A mund të prisni pak ju lutem?" Ndërkohë ne, me pirunë në dorë, me sytë tek torta dhe goja që na lëshonte lëng kur po thoshim: "Ooo gjysh!", gjyshi i bëri një pyetje motrës.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Mbesa ime e bukur, a ka mundësi që mos të të dojë ajo që e ka bërë këtë tortë për ty dhe ta ka dhuruar?

Motra ime, duke vështruar mamin tha:

-O gjysh i dashur, a mund të ndodhë diçka e tillë, mua mami më do shumë.

Gjyshi im:

-Shumë mirë, ngaqë të do dhe të vlerëson e ka bërë këtë tortë siç të pëlqen ty, apo jo?

-Po, gjysh.

-Nipërit e mi të dashur, ju lashë të prisnit pak që t'ju mbetej në mendje, të më falni! Kam dëshirë të ndaj me ju një mësim jete që dua të mos e harroni asnjëherë. Le të mendojmë njëherë: Ju e kujtoni më shumë nënën, që ka bërë tortën, kur thoni se sa e mirë është torta apo kur thoni se sa mirë nëna e ka bërë për ne?

Unë dhe motra:

-“Patjetër që kur themi të dytën gjysh i dashur”-u përgjigjëm.

Gjyshi im:

-“Nipërit e mi të zgjuar, ja pra këndvështrimi i dytë është shumë ndryshe. Dashurinë, mëshirën e nënës suaj të dhembshur dhe faktin që ndan kohë për të bërë për ju këtë



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

tortë të mirë, e kuptoni me këtë këndvështrim. Kur thoni: “Torta qenka e mirë ose torta qenka bërë shumë e mirë” nuk e sillni shumë në mendje bërësin e saj. Ndërsa kur thoni: “Sa e mirë qenka bërë torta, edhe ashtu siç e dua unë.” nuk ju del nga mendja nëna juaj, që e ka bërë atë. Hajde filloni, thoni “Bismilah”. Ta hamë këtë tortë të mirë duke falënderuar nënën tuaj. Më pas do t’ju jap dhuratat që kam sjellë për secilin nga ju dhe që mendoj se do ju pëlqejnë shumë. Një herë tjetër do ju tregoj edhe se si të mendojmë rreth universit me këtë këndvështrim, inshallah. “ -tha. Mësues, me këtë shembullin e mollës e kuptova më mirë që, gjyshi donte të na shpjegonte ndryshimin mes të parit tortën dhe të parit prej tortës.

Zoti Jusuf me buzëqeshje:

- Ali Khan e di me siguri që gjyshi ju do shumë juve. Mos do t’ju shpjegojë edhe diçka tjetër gjyshi juve?

Ali Xhani, me pak habi:

-Si për shembull mësues? -tha

Zoti Jusuf:

-Si për shembull diferencën mes të parit dhuratën dhe të parit prej dhuratës.

Duke buzëqeshur me entuziazëm, Ali Xhani:

-Po, keni shumë të drejtë. Nuk e kisha menduar fare këtë.

Saiti që e ndjek mësimin me shumë vëmendje:

-Mësues, ky këndvështrim qenka vërtet shumë ndryshe. Një këndvështrim që lidh njeriun me Krijuesin. Të falënderojmë.

Tani mësimi ishte drejt mbarimit, për pak do binte zilja.

Zoti Jusuf:

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Nxënës, do të kem një lajm të mirë për ju nesër.

Fëmijët me kureshtje:

-Çfarë është ky lajm i mirë, mësues?

Zoti Jusuf:

-Jini pak kureshtarë deri nesër. Kur të vini në shkollë në mëngjes do ta ndaj këtë lajm me klasën tuaj.

Fëmijët ikën në shtëpi me mendimin: “Vallë çfarë lajmi do të na japi mësues Jusufi nesër?” Ishin vërtet kureshtarë. Çfarë do të thoshte mësues Jusufi, që në të njëjtën kohë ishte mësuesi kujdestar i klasës? Donin ta zbulonin, por nuk kishin asgjë në dorë për këtë. Një pjesë e nxënësve ranë dakord për tu takuar tek libraria përballë shkollës, pasi të kishin shkuar në shtëpi dhe të kishin ngrënë bukë. Elifi erdhi në shtëpi dhe përshëndeti nënën e saj. Ndërroi rrobat e shkollës. Ajo, duke thënë “Bismil-lah”, filloi të hante, biskotat me mollë, të sapo dala nga furra, që nëna e saj kishte përgatitur. Kur pa këto biskota iu kujtua shembulli i të parit mollën dhe të parit prej mollës. “I paske bërë vërtet shumë të mira, të lumshin duart nënë e dashur!” - i tha nënës së saj.

-Gjak e dhjamë bija ime. Si je? Si të shkoi dita? Duke pyetur filloi të fliste me Elifin. Nëna e saj e pyeste Elifin kur kthehej nga shkolla: “A i ke bërë pyetje mësuesve sot bija ime?” Më pas: “Bija ime, nëse nuk ka pyetje nuk ka as përgjigje. Është shumë e rëndësishme të bësh pyetje me vend. Sa mirë e kanë thënë të parët tanë...” -thoshte dhe me një melodi të ëmbël tha fjalinë: “Nuk pyet që të dijë, po të dinte pyeste. Nuk di që të pyesë, po të pyeste dinte.”

Elifi duke i thënë: “Po, bëra pyetje nënë e dashur.” e përmbloodhi mësimin e zotit Jusuf me një frymë dhe ia tregoi nënës së saj gjërat që kishte mësuar në shkollë, me entuziazëm.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Mami, mësuesi jonë nesër do na japë një lajm të mirë. Jam shumë kureshtare, vallë çfarë lajmi është ky? U bëmë kureshtarë bashkë me shokët e mi dhe shoqet e mia se çfarë mund të jetë ky lajm që do t'i jepet vetëm klasës tonë.

Nëna e saj:

-Kureshtja është i bukur, por durimi është më i bukur bija ime. Duroni pak, nesër mësuesi juaj do t'ua thotë atë lajm inshallah. Edhe ju qetësoheni.

Elifi:

-Mami, nëse më lejon, ramë dakord me shokët dhe shoqet që të takohemi në orën katër tek libraria përballë shkollës. Nëna e saj:

-Në rregull. Nëse shkon dhe vjen në kohë.

Flokbore, s'ka si ti

Elifi kishte dëshirë të shkonte në librari dhe sidomos të shihte Flokboren. Në orën katër u takuan në librari. Edhe Fatma, Nesibeja, Rejani, Betyli erdhën në kohë, siç kishin dhënë fjalën. Libraria ishte e qetë. Koka e madhe e dyqanit, Flokbora, mirpriste tek dera ata që vinin. Flokbora sikur ishte më e bardhë sot. Sikur shkëlqente më shumë kur dielli i pasdites e ndriçonte. Kur fëmijët mbërritën, atje panë edhe mësuesin e tyre, z. Jusuf. Mësuesi i tyre, ishte përhumbur në një bisedë të thellë me xhaxhi Omerin. Fëmijët i përshëndetën ata. Elifi ishte e urtë, por ishte shumë e aftë për të bërë pyetje me vend. Meqë libraria ishte në qetësi dhe mësuesi ndodhej aty, donte të bënte një pyetje që e kishte në mendje prej shumë kohësh. Papritur: - Xhaxhi Omer, a mund të pyes diçka?


-Urdhëro bijë, Elif.

-Pse ia keni vënë emrin Flokbore maces tuaj?

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Khaxhi Omeri duke buzëqeshur:

-E vërtetë. Ke të drejtë. Je kureshtarë, pse Flokbore dhe jo Pambuk ose Buçko? Edhe zoti Jusuf e di përgjigjen e kësaj pyetjeje. Po s'po e di, a ta jap unë përgjigjen apo ta japë ai.



Z. Jusuf, me një shprehi gjithë respekt:

-Urdhëroni ju, ju lutem, mësues i nderuar!

Khaxhi Omeri e filloi fjalën duke thënë:

-Atëherë me lejen tuaj z. Jusuf. Elif, bijë ishim në stinën e dimrit. Në një natë të ftohtë me borë, po bisedonim në dyqan me miqtë tanë, si z. Jusuf. Papritur filloi të bjerë dëborë flokë flokë. Rënia e dëborës krijonte një peizazh shumë të bukur. Bashkë me miqtë tanë u ngritëm nga tavolina për të parë me admirim dëborën që binte. Flokët e borës endeshin në erë dhe pa u përplasur me njëra tjetrën, secila prej tyre binte në vend të ndryshëm. Në atë moment mes nesh filloi një bisedë tefekkuri, pra mendimi. Po thoshim që flokët e borës nuk janë të njëjta, çdo flok bore që bie në tokë është e vetme dhe flokët e borës janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ndërkohë që po thoshim që, fakti që kjo ndryshueshmëri është dëshmi

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



e vetmisë së Allahut dhe gjithditarisë së Tij, ndodhi diçka interesante.

Fëmijët me kureshtje:

-Çfarë ndodhi xhaxhi Omer?


-Papritur në derën e dyqanit, u shfaq një kotele e vogël, e bardhë. Ishte e uritur dhe kishte ftohtë. Atë e futëm menjëherë brenda në dyqan. E afruam pranë kaloriferit dhe e mbuluam me peshqirë të thatë. I dhamë qumësht të ngrohtë. Ndërkohë që kotelja thahej filloi të bëhej më e lezetshme, filloi të bënte lëvizje që na pëlqenin. Kur barku i ishte ngopur, filloi të lozte me gëzim. Ne, që u bëmë pjesë e kësaj ngjarjeje, e pëlqyem shumë këtë kotele. Kur po flisnim se si t'ia vëmë emrin, dikush tha Buçko, dikush Pambuk... Ndërsa kur z. Jusuf tha: "Si thoni, t'ia vëmë emrin Flokbore, pra flok dëbore, një miku që ka ardhur ndërkohë që po bie borë flokë flokë?", të gjithëve na hyri në zemër menjëherë ky emër. Që pas asaj dite, atë e kemi thirrur gjithmonë Flokbore. Mendoj se edhe ajo e pëlqeu shumë këtë emër.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Në ato çaste Flokbora, u hodh në prehër të xhaxhi Omerit. Të gjithë ata që ishin aty u habitën dhe qeshën me këtë situatë. Ndërkohë që po pinin çaj, Fatma duke thënë: “A mund të bëj edhe unë një pyetje?”, iu drejtua zotit. Jusuf.

-Patjetër Fatma!

-Mësues, meqë fakti që çdo flok dëbore është e ndryshme, është dëshmi e njëshmërisë së Allahut. Përveç flokëve të



dëborës, nga cilat krijesa të tjera mund të japim shembull për njëshmërinë e Allahut?

Z. Jusuf pasi tha: “Pyetje e bukur.” i kërkoi të gjithëve atyre që ndodheshin aty, të shikonin fytyrën e njëri-tjetrit. Vajzat që ishin në tavolinë, pa e kuptuar se ç’po ndodh, panë fytyrën e njëra-tjetrës. Ndërkohë, edhe Flokbora po i shihte ata në një mënyrë të çuditshme.

Z. Jusuf:

-A ka ndonjë nga ju që e ka fytyrën kopje të njëjtë me një tjetër? Nxënësit thanë: “Nuk ka.”

-Po në shkollë a ka një të njëjtë me një tjetër?

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Nxënësit sërish thanë: “Nuk ka.”

-Po në Yskydar?

-Jo.

-Po në Stamboll, në Turqi?

-Nuk ka.

Z. Jusuf të njëjtën pyetje, duke e zgjeruar: “Po në Azi, Europë, madje edhe në botë, a ka?” -pyeti.

Nxënësit thanë sërish: “Nuk ka.”

Z. Jusuf:

-Pra nxënës, që Allahu është një dhe i vetëm mund ta kuptojmë nga fakti që fytyrat e të gjithë njerëzve janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ka miliarda njerëz dhe asnjë fytyrë nuk është kopja e një tjetre. Një fytyrë i jepet vetëm një personi. Ajo fytyrë nuk i është dhënë as paraardhësve dhe nuk i jepet as pasardhësve. Sepse çdo ADN, që ruan veçoritë e njeriut, është e ndryshme dhe e krijuar në mënyrë të veçantë për të gjithë. Dhe, kjo tregon njeshmerinë e Allahut, i Cili kur krijon njerëzit di çdo veçori dhe mes mundësive të pafundme zgjedh dhe krijon atë fytyrë. Allahu i di fytyrat e atyre që ka krijuar dhe atyre që do të krijojë dhe i dhuron atyre fytyrë të veçantë. Nëse të gjitha fytyrat, nuk do të krijoheshin nga Allahu i Gjithëdijshëm, atëherë të gjitha do të ngatërroheshin me njëra-tjetrën. Pra të gjithë njerëzit, të ndryshëm nga njëri-tjetri i ka krijuar Allahu, që nga njeriu i parë Ademi (a.s.). Zoti do të tregojë dijen e pafundme dhe fuqinë e pakufishme, duke e krijuar çdo njeri ndryshe të tjerët.

Fatma:

-Mësues, po shenjat e gishtave a mund të jenë shembull për këtë që shpjeguat?

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Patjetër Fatma, shembujt mund të shtohen. Duke qenë se dija e Zotit tonë është e pafundme, shenjë e

gishtit që ia ka dhënë një neriu nuk ia jep një njeriu tjetër. Çdo njeri që lind, lind me një përsosmëri të pashoqe. Shenja e gishtit që i është dhënë një bebeje, nuk i është dhënë dhe këtë e mbrapa nuk do t'i jepet askujt tjetër. Gjithashtu, cipën e irisit të syve të një bebeje nuk e ka askush tjetër të njëjtë. Betyli, duke kërkuar fjalën:

-Mësues, kam lexuar që sistemi i sigurimit shifror i disa bankave punon duke u lidhur me cipën e irisit të syve tanë.

-E vërtetë. Në disa vende, kodet bëhen me procesin e skanimit nëpërmjet cipës së irisit. Për shembull, tek telefona, në sistemet bankare dhe në hyrjet e dyerve të hyrjeve private përdoret për siguri. Tani, fëmijë! Telefonat, kamerat, dyert digjitale që përdorin sistemet e njohjes së fytyrës dhe skanimin nëpërmjet irisit të ketë një mjeshtër dhe artist por, fytyra e përsosur dhe syri i mrekullueshëm i njeriut të mos ketë një krijues! A e pranon logjika këtë? T'i japësh veçori një njeriu pa ardhur akoma në këtë botë, ndryshe nga tetë miliard njerëzit në botë, mund të ndodhë vetëm me krijimin nga një Krijues i Gjithëdijshtëm. Kjo gjendje siç është dëshmi për vetminë e Allahut, në veçanti është dëshmi edhe që Allahu sundon universin, si Krijues, në çdo moment.



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Të shohësh universin në mënyrë holistike

Nesibeja:

-Mësues, më tërhoqi vëmendjen tema që Allahu e sundon universin në çdo moment, a mund ta shtjelloni pak?

Z. Jusuf:

-Kjo është vërtet një temë e rëndësishme, Nesibe. Kemi një Zot që sundon çdo anë të universit në çdo moment. Ne, kur e shohim universin në mënyrë holistike, e shikojmë këtë. Çdo gjë në univers, e madhe apo e vogël, veprojnë për të njëjtin qëllim. Punojnë për të zbatuar një qëllim të përbashkët. Fakti që një grimcë e pandërgjegjshme bën punë të ndërgjegjshme, bën të nevojshme të mendohet kuptimi së bashku me grimcën. Kush është ai që i mbledh krijesat rreth një qëllimi dhe i jep detyra? Për shembull retë, vrapojnë të ndihmojnë bimët. Dielli, për të qenë burim jetese vrapon të ndihmojë të gjitha gjallesat. Bimët, vrapojnë të ndihmojnë kafshët. Këtë e shohim. Por, këtu ka një situatë që është interesante. Ajo është që, këto që përmendëm nuk e njohin dhe nuk e dinë njëra-tjetrën. Kjo do të thotë që, ka një Allah që i dëgjon krijesat dhe u plotëson atyre nevojat. Ai është Allahu që, u jep atyre detyra dhe i bën të vrapojnë në ndihmë të njëra-tjetrës. Mund të kërkonti një shembull edhe nga xhaxhi Omeri për këtë temë.

Xhaxhi Omeri, duke përkëdhelur kurrizin e Flokbores:

-E shpjeguat vërtet shumë bukur. Të ndaj dhe unë një shembull që më ka lënë mbresa. Lënda, për të cilën ne gjallesat kemi më shumë nevojë është oksigjeni, apo jo?

Nesibe:

-Nëse s'ka oksigjen s'marrim dot frymë dhe nëse s'marrim dot frymë vdesim.


TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Xhaxhi Omeri:

-Oksigjenin e gjejmë menjëherë, që në momentin kur lindim, pa patur nevojë ta kërkojmë, apo jo?

Fëmijët: “Po xhaxhi Omer”

Të dashur fëmijë, për më tepër jo vetëm njerëzit por të gjitha gjallesat...



Në atë çast Flokborë mjaulliu në një mënyrë të ëmbël, sikur të thoshte: “Jam edhe unë këtu, mos më harroni.”

Xhaxhi Omeri duke buzëqeshur:

-Për shembull, si Flokborë, të gjitha macet kanë nevojë për oksigjenin sapo të lindin. A mund të jetë e rastësishme, të sillen e oksigjeni nën hundët tona falas dhe me sasi të madhe, pa

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

patur nevojë ta kërkojmë? Ma thoni ju. Pastaj, një tjetër pikë e rëndësishme është kjo. Siç thonë dijetarët, ajri që thithim në atmosferë ka 78%azot dhe 21%oksigen. Ky përpjesëtim është shumë i rëndësishëm për vazhdimësinë e jetës. Nëse ne do të thithnim një ajër që është i përbërë i gjithi nga oksigjeni, kjo gjë gradualisht do të bëhej shkak i vdekjes tonë. Sepse oksigjeni, 100%, do t'i dëmtonte qelizat tona. Nuk do të kishte jetë të tokë. Tani, të dashur fëmijë, gazrat që janë kaq të rëndësishme për jetën dhe balancën e sasisë së tyre, a mund ta krijojnë krijesa të pandërgjegjshme dhe të pajeta, të cilat nuk e njohin njeriun? Ekzistenca e oksigjenit është më e rëndësishme se sa zbulimi i rrotës apo i mjeteve prerëse nga njerëzimi. Pra, këtu ju tërheq vëmendjen! Kush i urdhëron pemët dhe veçanërisht algat e deteve, e oqeanëve të prodhojnë oksigjenin, nevojën më themelore për të mbijetuar? Prapa këtyre gjërave materiale kemi Zotin tonë që e do, e mëshiron dhe i plotëson nevojat njeriut në çdo çast. Ashtu që, Zoti urdhëron algat e deteve dhe të oqeanëve të prodhojnë 70% të oksigjenit që përdoret në botë. Ndërsa pjesa e mbetur prodhohet bimët. Për këtë arsye, algat e ujit janë të domosdoshme për jetesën. Nëse e vështrojmë gjithësinë me një këndvështrim holistik, do të shohim që të gjitha krijesat vihen në veprim për një qëllim të përbashkët. Në këtë mënyrë, fillojmë të njohim Zotin që është një dhe i mbledh të gjitha krijesat rreth një qëllimi.


Rejana pyeti me kureshtje:

-Si i bën gjithë këto gjëra Allahu pa pasur ndihmës, xhaxhi Omer?

-Rejana, bijë bëre një pyetje shumë të bukur. Fëmijë! Ne njerëzit, prej paaftësisë, paditurisë dhe prej kufizimit kemi nevojë për ndihmën dhe mbështetjen e dikujt tjetër. Allahu i Gjithëdijsëm dhe i Plotfuqishëm, nuk është ashtu,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

përkundrazi. Allahu i Lavdëruar, nuk i ngjan krijesave të Tij, nuk është si ato. Nuk ka nevojë për asgjë. Sepse çdo gjë, të gjallë dhe jo të gjallë, e ka krijuar Ai. Çdo gjë është krijuar sepse e ka krijuar Ai. Të gjitha krijesat vazhdojnë të ekzistojnë falë Tij. A mund të ketë nevojë për krijesat e Tij, Allahu që ka krijuar gjithçka? Patjetër që jo. Sepse fuqia e Allahut është




e pafundme, për këtë. Duke qenë se, pasuria e Tij, është e pakufishme nuk bëhet fjalë të ketë nevojë për dikë tjetër.

Fëmijë të çmuar! Këtë temë dua ta shpjegoj me një shembull. Për shembull, dielli në qiell është një. Por, me vetinë e pasqyimit dielli pasqyrohet në të gjitha pasqyrat e shndritshme, bulëzat e ujit, sipërfaqet e deteve. Dielli depërton në çdo gjë pasqyron, si këto, dhe i ndriçon e i ngroh ato. Depërtimi në njërën prej nuk e pengon depërtimin e tij në një tjetër. Dielli gjendet me pamjen, dritën dhe ngrohtësinë e tij në çdo gjë që depërton. Ai mund të veprojë me lehtësi,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

njëkohësisht në vende të panumërta. Për më tepër, kur i bën të gjitha këto veprime nuk ka nevojë për një diell tjetër. Siç e shikoni, edhe dielli, që është krijesë e Zotit tonë, vepron në shumë vende njëkohësisht. Pra, në të njëjtën mënyrë Allahun E Lavdëruar, një punë nuk e pengon të bëjë një punë tjetër. Zoti që është një dhe i vetëm, bën çdo punë me lehtësi në të gjitha vendet, pa patur nevojë për asgjë. Siç ia jep rrishtun një pemë në një cep të botës, njëkohësisht ushqen edhe një peshk në thellësitë e deteve, siç qarkullon galaktikat me rregullsi, në të njëjtën kohë me lehtësi qarkullon edhe atomet.



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Rejana:

-Xhaxhi Omeri shumë faleminderit. Shyqyr Zotit, falë jush arrita të zgjidh një pikë që më kishte ngelur në mendje.

Në mëngjes pa filluar akoma mësimi i parë z. Jusuf erdhi në klasë. Fëmijët ishin të padurueshëm.

Ali Xhani:

-Mësues mezi e kam gdhirë, ju lutem thojeni tani këtë lajm.

Rejana:

-Ju lutem mësues, çfarë është ky lajm që do ja thoni vetëm klasës tonë?

Mustafai:

-Edhe familjarët tanë janë kureshtarë mësues. I tregova gjyshes sime të moshuar, edhe atë e shtyn kureshtja.

Z. Jusuf, duke pritur të qetësohet klasa:

-Ju uroj të gjithëve një ditë të mbarë! Këtë fundjavë do të ketë një konferencë për nxënësit e 9-vjeçares në universitetin e Islamit dhe Shkencave, në Stamboll. Kam dëshirë të bëheni edhe ju pjesë e saj, si mësuesi juaj kujdestar. Keni dëshirë të vini?

Papritur, klasa u vu në lëvizje me gëzim. Nxënësit ishin të entuziazmuar. Kur Saiti, kujdestari klasës tha: "Po mësues, vijnë me shumë dëshirë, apo jo shokë?" e gjithë klasa: "Patjetër, vijnë me gjithë dëshirë." -bërtiti.

Z. Jusuf:

-Qetësohuni shokë, të mos i shqetësojmë klasat e tjera ju lutem!

Javuzi:

-Për cilën temë do të mbahet konferenca mësues?

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Z. Jusuf me buzëqeshje:

-Duke thënë: “Një pyetje e bukur dhe me vend.” tha që konferenca titullohej: “Shkencat tregojnë Allahun”. Jua rekomandoj të gjithëve këtë konferencë. Ja pra fëmijë, një rast për të forcuar imanin. Një mundësi konference për të rritur ndërgjegjësimin ndaj imanit. Në këtë konferencë, akademikë nga shumë degë të ndryshme të shkencave do të bëjnë prezantime të shkurtra për nxënësit e 9-vjeçares. Do të tregojnë Zotin tonë me shembuj nga jeta e përditshme.

Nxënësit u gëzuan shumë. E si të mos gëzoheshin... Do të ishte bukur të kalonin fundjavën bashkë me mësuesin që donin. Madje, numri i atyre që nuk kishin hyrë asnjëherë në një kampus universiteti nuk ishte i vogël. E pranuan propozimin e z. Jusuf duke thënë të gjithë njëherësh: “Në rregull.” Ditën e shtunë, pasi u takuan në skelën e targetit, në Yskydar dhe kaluan në anën tjetër, do të nisnin udhëtimin për të shkuar në universitet, me autobusin që kishin marrë me qira.

Udhëtimi për në universitet

Dita e konferencës kishte ardhur. Koha ishte shumë e bukur. Familjarët i sollën fëmijët në vendin e takimit dhe ia lanë amanet në fillim Allahut më pas mësues Jusufit. Nxënësit nuk kishin veshur uniformën e shkollës, por rrobat që donin. Ndërsa z. Jusuf kishte veshur kostum dhe këmishë të bardhë. Kujdestari i klasës, Saiti, e kontrollloi listën për herë të fundit dhe tha: “Në rregull mësues. Jemi mbledhur shtatëmbëdhjetë veta pa mungesa, ne jemi gati.” Vazhduan drejt portave për të hipur në target. Po, tashmë ishin në target. U ngjitën në katin e fundit të targetit. Filluan të vështronin detin, Bosforin, qiellin. Rrezet e diellit binin mbi sipërfaqen e detit dhe rrezet që pasqyroheshin krijonin një peizazh të mrekullueshëm.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Nga njëra anë frynte një erë e ëmbël dhe valëviste flokët e të gjithëve. Pulëbardhat afroheshin afër tyre sikur donin t'i përshëndesnin. Shitësi i simiteve që ndodhej atje: "Simite, erdhi simitja." -bërtiste. Fëmijët morën simite nga shitësi dhe filluan t'ua hedhin pulëbardhave. Pulëbardhat me një profesionalizëm të pabesueshëm i kapnin copat e simiteve në ajër dhe largoheshin nga tragetit për t'i ngrënë ato. Fëmijët dhe disa pasagjerë po shihnin me admirim fluturimin dhe afrimin e tyre.

Z. Jusuf fëmijëve, që tashmë nuk iu kishte mbetur më simite për të hedhur, u tha:

-Nxënës, a e keni menduar ndonjëherë se si mund të fluturojnë pulëbardhat? "Nuk e kam menduar asnjëhere." "Por nuk është se s'jam kureshtar." -tha Ali Xhani.

Z. Jusuf:

-Bukur. Shumë mirë që je kureshtar Ali Khan. Sepse kureshtja është mësuesi i të gjitha dijeve. Fëmijë! Kureshtja e drejton njeriun të pyesë dhe të kërkojë. Kur jemi kureshtarë dhe pyesim na rritet admirimi për krijesat dhe Zotin tonë.


Për të njohur më nga afër një person që e njohim pak bëjmë pyetje, apo jo? Dhe sa më më shumë e njohim atë, aq më shumë e duam. Në të njëjtën mënyrë, për të njohur Zotin tonë duhet të bëjmë disa pyetje. Duhet të mendojmë mbi krijesat që ka krijuar Allahu. Duhet të hulumtojmë.

Për shembull, një pyetje për të gjithë ne... Kur e ndërtuan avionin e parë me krahë njerëzit dhe kur fluturuan?

Nesibja, që ka interes për avionët dhe mjetet ajrore, mori fjalën.

-Mësues, vëllezërit Wright, nëse nuk gabohem arritën të fluturojnë me sukses në vitet 1900, me një avionin me helikë që kishin ndërtuar.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



Zoti Jusuf:

-Bravo Nesibe! Ne njerëzit kemi arritur të fluturojmë me avion më 1903. Pra, para njëqind e ca vitesh. Vetëm se, fluturimi i parë i vëllezërve Wright, zgjati vetëm 12 sekonda. Kurse zogjtë, insektet, bletët fluturojnë prej qindra vitesh. Unë jam kureshtar. Si fluturojnë zogjtë? Kush i mban ata në ajër? Nga i dinë zogjtë ligjet e fluturimit, që njeriu i ka zbuluar vetëm disa dekada më parë? Si mund të fluturojnë pa u rrëzuar, pa u përplasur? Si e fituan këtë aftësi pa u përgatitur?

Ali Xhani, pak si me shaka: “Më falni mësues, por disa thonë për zogjtë ‘tru zog’.”

Zoti Jusuf:

-Po, ka që thonë ashtu. Por si mund që, kafshët që i nënvlerësohen nga disa si “tru-zog”, të mësojnë fluturimin mijëra vite para njeriut, që është gjallesa më e logjikshme? Ne, si “tru-njerëz”, duhet ta shqyrtojmë këtë, apo jo? Për shembull, zogjtë migrues vijnë çdo vit në vendin tonë. Madje,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

ju i dini nga kohët e mëparshme lejlekët që vinin mbi çatinë e shkollës. Këto zogj, si nisen nga mesi i Afrikës dhe përshkojnë mijëra kilometra rrugë çdo vit? Si e gjejnë rrugën pa u ngatërruar, pa busull dhe pa navigacion? Mjetet e busullës dhe të navigacionit, i zbuluan më parë njerëzit apo zogjtë?

Zoti Jusuf i vazhdoi fjalët kështu:

-Nxënës të çmuar! Zoti i ka krijuar zogjtë të përshtatshëm për të fluturuar, peshqit të përshtatshëm për të notuar. Ndërsa disa njerëz i ka krijuar të përshtatshëm për të menduar duke vëzhguar universin dhe krijesat në të, që janë mrekulli e krijimit. Për këtë arsye, ndjenjat dhe logjikën që nuk ua ka dhënë kafshëve, na i ka dhënë neve.

Tashmë trageti po i afrohej skelës dalëngadalë. Të gjithë pasagjerët filluan ecnin drejt shkallëve të daljes. Gjatë atij momenti, pulëbardhat që ndiqnin tragetin fluturonin me kënaqësi duke hapur e mbyllur krahët, sikur donin të tregonin diçka.

Rregulli, është dëshmi e Rregulluesit

Kur zbritën nga trageti, u mblodhën sërisht në grup. Secili pa shokun që kishte pranë. Klasa ishte në rregull. Në një vend, jo shumë larg skelës, dukej minibusi me ngjyrë të bardhë.

Zoti Jusuf:

-A keni dëshirë të bëjmë garë vrapi deri tek ai minibusi i bardhë?

Fëmijët plot energji, të gjithë njëherësh thanë: “Poo, mësues.”

-“Ejani pra, atëherë nxënësit dhe nxënëses që prekin minibusin të parët do t’ju dhuroj nga një çokollatë.” -tha. Gara filloi. Vrapuan afërsisht dyqind e pesëdhjetë metra. Kishte një situatë interesante. Çudi! Ali Xhani që i preferon shumë gjërat

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

e tilla, nuk po vraponte por po nxirrte diçka nga çanta. Po ajo ç'të jetë? O Zoti im, Ali Xhani kishte sjellë patinat! Ai i veshi patinat nxitimthi dhe u bë pjesë e garës.

Nxënësit vraponin frymë më frymë. Gara vazhdonte të ishte e fortë. Nga djemtë më përpara ishte Saiti, nga vajzat ishte Betyli. Ali Xhani me patinat e tij iu afrua shumë atyre. Megjithatë, në pesëdhjetë metrat e fundit Ibrahimimi dhe Rejana u hodhën në sulm dhe u bënë të parit që prekën minibusin. Kurse Ali Xhani e kishte prekur minibusin në një kohë me Saitin. Saiti u habit shumë nga kjo situatë. Z. Jusuf duke ardhur pak më mbrapa: "Jeni si era fëmijë, mashallah! Por, Ali Khan nuk e quajmë që ti e preke autobusin, sepse nuk ke respektuar rregullat."-tha.

Keni të drejtë mësues, rregullat janë për të gjithë, duhet t'i zbatojmë rregullat. Z. Jusuf nxorri nga xhepi dy çokollatat, që i kishte përgatitur më parë. Ua dorëzoi fituesve të garës

Rejanës dhe Ibrahimimit. Fëmijët ishin lodhur pak, po u kishte bërë mirë edhe aksioni. Ibrahimimi që mori dhuratën po fliste me gëzim, pak po i merrej edhe fryma:

-Mësues, çokollata është shumë e shijshme, por të shijon më shumë kur e merr dhuratë nga ju.

Hasani duke hyrë në fjalë:

-Mësues, shoku ynë Ibrahimimi e paska mësuar mirë mësimin e ditës së kaluar. Shikojeni, nuk sheh dhuratën por sheh prej dhuratës.



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Zoti Jusuf:

-Të dy keni të drejtë. Është shumë bukur të praktikoni në jetën e përditshme gjërat që mësoni. Kemi rrugë të gjatë, të flasim për këtë temë në autobus. Pas apelit të fundit dyert e autobusit u mbyllën dhe u nisën drejt universitetit. Z. Jusuf mori në dorë mikrofonin që te mund bëjë transmetim brenda mjetit, duke i kërkuar leje shoferit: "Udhëtim të mbarë, nxënës. Kemi një rrugë rreth dyzet minuta. Nëse trafiku qarkullon në këtë mënyrë, do mund të arrijmë në kohë në program. Të bëjmë dua! Ju e dini që trafiku i Stambollit është i mbushur me surpriza.

Ali Xhani, duke thirrur nga njëra prej ulëseve të fundit:

-Mësues, sikur thatë që do flisnim për çokolatën dhuratë?

-Në rregull, të flasim nxënës. Le të mendojmë që të gjithë ne po kalojmë në një tunel kohe dhe po vizitojmë bërësin e shkollës tonë, banorin e xhenetit, Sulltan Abdylhamid Hanin. A do lumturoheshit nëse padishahu do të na dhuronte të gjithëve nga një laps, ku mbi ato shkruhen emrat tanë?

Ali Xhani:

-Kush nuk do të lumturohej mësues? Patjetër që lumturohemi shumë.

Zoti Jusuf:

-Do gëzoheshit më shumë që morët laps, apo që morët dhuratë prej dorës së padishahut?

Rejana:

-Ngaqë e morëm prej dorës së padishahut tonë mësues.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Z. Jusuf:

-Nëse gëzimi që të jep lapsi është një, marrja e lapsit nga dora e padishahut, njeriun e gëzon njëqind herë më shumë. Dhurata që ju jep padishahu tregon se ju do dhe ju vlerëson juve.

Pra fëmijë, kështu janë edhe mirësitë që vijnë nga Zoti. Për shembull, kur hamë një portokall ndjejmë shijen e këtij fryti. Kurse, kur mendojmë që na është dhuruar nga Allahu dhe kujtojmë Atë, atëherë shija e tij shtohet nga një në njëqind herë. Duke menduar se Allahu që na vlerëson, na mëshiron, na i plotëson nevojat, na afron me Allahun.

Udhëtim po vazhdonte me biseda të ëmbla. Ndaluan dhe morën karburant në një vend të përshtatshëm. Trafiku një herë bllokohej, një herë qarkullonte. Një fugon që parakaloi minibusin, po vepronte në kundërshtim me rregullat dhe po vinte në rrezik mjetet e tjera në trafik. Fatkeqësisht, ai fugon u bë shkak i një aksidenti diku përpara. Trafiku u bllokua, nuk qarkullonte. Shoferët zbritën dhe filluan të diskutonin. Situata duhet të qetësohej.

Zoti Jusuf zbriti bashkë me shoferin dhe u mundua të qetësojë situatën. Iu tha të ndërprisnin diskutimin, të vinin në rrugë shenjat e sigurimit dhe telefonoi policinë rrugore. Shenjat e sigurimit ishin të rëndësishme. Sepse, Allahu na ruajt, mund të vinin mjete të tjera e të përplaseshin me mjetet që kishin ndaluar. Shoferët pasi u qetësuan pak, bënë ato që i tha z. Jusuf. Në mjetin që kishte bërë aksident gjendej një fëmijë i vogël. Po qante nga frika. I thanë atyre: “Të shkuara.” Ndërsa fëmijët po i shikonin nga minibusi.

Rejana hapi xhamin e minibusit dhe tha:

-Mësues, unë nuk e kam ngrënë çokollatën që fitova në garë. Mund t’ia dhuroj atë fëmijës së vogël.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Z. Jusuf:

-Po, Rejana, mirë ke menduar. Të shoh, t'u them njëherë. Fëmija e pranoi dhuratën. Nëna e tij e hapi çokollatën dhe ia dha të birin ta hante. Djalit filloi t'i qeshte fytyra pak e nga pak.

Shoferi i fugonit kishte gabuar vërtet dhe ishte i vetëdijshëm për gabimin.

Minibusi u nis sërish. Filloi të ecte përpara. Edhe pse trafiku rëndohej herë-herë, shyqyr Zotit, po shkonin shëndoshë e mirë.

Nxënës, e shikoni sa të dëmshme janë nxitimi dhe papërgjegjësia. Allahu na ruajt, për pak mund të kishte ndodhur edhe një aksident më i madh.

Shoferi i minibusit:

-Mirë bëmë që zbritëm dhe i ndihmuam ata, mësues. Përndryshe mund të lindnin pasoja më negative nga diskutimi.

-Zoti shofer ne jem myslimanë. Kjo është përgjegjësia jonë. Nuk mund të jemi indiferentë ndaj problemeve të shoqërisë. Kur shohim një problem mundohemi të ndihmojmë me gjuhën tonë, dorën tonë. Nëse nuk bëjmë dot asgjë, bëjmë dua për njerëzit tanë. Disa zjarre mund të shuhen me një gotë ujë. Por, në qoftë se të gjithë ne themi se ç'më duhet mua dhe nuk interesohet, ai zjarr përhapet dhe mund të zgjerohet sa të na marrë të gjithëve brenda.

Trafiku ishte hapur disi tani. Tani lëvizej më lehtë.

Elifi me zë të ulët, i tha mësuesit të saj:

-Mësues, nuk e thash dot më parë për shkak të ngarkesës. Nëna ime më ka dhënë llokume, për të ëmbëlsuar gojën rrugës. A mund t'i ndaj këto me ju dhe me shokët?

Zoti Jusuf:

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Patjetër Elif, pse jo?! Siç kanë thënë të parët, të hamë ëmbël e të flasim ëmbël. Do të ishte shumë mirë edhe pas ngjarjes së mëparshme.

Elifi nxorri nga çanta dy kutitë e mëdha të llokumeve. Njërën ia zgjati çunave mbrapa. Ndërsa tjetrën do ta hanin vajzat dhe ata që ndodheshin afër shoferit. Ali Xhani që hapi kutinë e dërguar mbrapa e tregoi gëzimin:

-Allaah, mësues këtu ka një thesar. Me të vërtetë, llokumet me trëndafil, arrë, lajthi, me kajmak, që ishin rreshtuar ngjyra-ngjyra, dukeshin si një thesar. Nxënësit duke falënderuar Elifin dhe nënën e saj të gjithë së bashku, filluan të hanin llokumet në kuti, me kënaqësi. Z. Jusuf gjithashtu i falënderoi, Elifin dhe nënën e saj. Duke marrë sërish mikrofonin në dorë, hapi një tjetër derë tefekkuri.

-Fëmijë, siç e shikoni pak më parë u përballëm me një aksident. Megjithëse çdo mjet në trafik ka një shofer të rritur. Njerëzit e mençur pasi kanë marrë një mësim të caktuar mund t'i përdorin këto mjete. Leja e drejtimit nuk u jepet atyre që nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që nuk e kalojnë me sukses provimin. Rregullat e qarkullimit janë caktuar, sinjalet dhe dritat e trafikut janë vendosur kudo.

Policët janë vazhdimisht në punë për kontroll. Aty ku nuk ka polic, ka sistem elektronik kamerash. Edhe pse janë marrë masa të tilla, prap aksidentet ndodhin. Në fakt edhe ne u bëmë dëshmitarë të një aksidenti.

Ahmeti duke marrë fjalën:

-A janë rregullat e qarkullimit të njëjta në çdo vend të shtetit tonë, mësues?

-Po Ahmet, rregullat e qarkullimit janë të njëjta në çdo vend të shtetit tonë. Rregullat e qarkullimit që zbatohen në shtetin tonë

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

siç tregojnë ekzistencën e shtetit, tregojnë edhe që është një dhe i vetëm. Sepse nëse në çdo vend ka rregullt të rregullt, ai rregull është dëshmi për ekzistencën e rregulluesit. Asnjë rregull dhe ligj nuk caktohet vetvetiu. Nëse një rregull vihet në zbatim gjithkund në të njëjtën mënyrë, kjo tregon që ai rregull e ka një burim.

Tani, le të mendojmë njëherë! Yjet, planetët, satelitët që lëvizin në hapësirë veprojnë sipas një rregulli dhe një ligji. Kush i vendosi ligjet dhe rregullat që zbatojnë trupat qiellorë? Kur shkencëtarëve që zbulojnë këto rregulla u jepen çmime, a nuk duhet të mendojmë se kush i ka caktuar këto ligje dhe i vë në zbatim çdo moment me rregullsi në çdo vend?

Si lëvizin trupat qiellorë me rregullsi dhe pa u përplasur me njëri-tjetrin? Kush e përcakton rrugën e tyre? Apo, mos kanë ndonjë shofer?

Hasani:

-Mësues, po yjet dhe planetët nuk kanë shoferë!

-Ke shumë të drejtë Hasan. Me fuqinë e kujt, me dijen e kujt lëvizin me rregullsi këto trupa qiellorë? Ashtu që, edhe pse shpejtësitë, madhësitë, orbitat dhe drejtimet i kanë të ndryshme, si mund të mos përplasen me njëra-tjetrën këto masa të mëdha, jo të gjalla, të palogjikshme dhe pa shofer? Kjo është një gjendje e habitshme, apo jo?

Saiti:

-Mësues, ka mjete që lëvizin me inteligjencë artificiale, mjete ajrore pa pilot, madje ka edhe trenë.

Z. Jusuf:

-Ke të drejtë Sait, një perceptim i bukur. A ka specialistë që planifikojnë pajisjen e mjeteve që drejtohen pa njerëz?

-Si nuk ka, mësues.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-A ka inxhinierë kompjuteri që shkruajnë kode me qindra rreshta?

-Ka.

-A ka inxhinier menaxhimi që i drejton ato mjete sipas funksionit?


-Po, edhe ata janë mësues.

-Nxënës të çmuar, kjo teknologji e avancuar është vetëm në tetë a dhjetë shtete në botë. Pra është një teknologji që njerëzimi sapo e ka zbuluar. Po trupat në hapësirë kështu janë? Ata pa qenë inxhinierë dhe profesionistë të kësaj pune, arrijnë ta kryejnë me sukses. Megjithëse nuk janë të ndërgjegjshëm, kryejnë lëvizje shumë të vetëdijshme.

Pas kësaj hyri në fjalë Mustafai, që është kureshtar për shkencat e hapësirës:

-Po mësues, duhet t'i studiojmë dhe të bëjmë kërkime për trupat e hapësirës. A mund të ndaj diçka me ju në lidhje me këtë temë, që më fut në mendime?

Z. Jusuf i zgjati mikrofonin duke i thënë:



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Hajde pra, merre mikrofonin dhe fol, që të gjithë të dëgjojnë më mirë.

-Mësues, pak më parë morëm karburant për mjetin tonë. Me këtë karburant do ecim për një kohë të caktuar. Kur të mbarojë, xhaxhi shoferi do ndalojë sërish diku për të mbushur serbatorin e mjetit. Dy gjera më impresionojnë më shumë. E para, si lëvizin trupat, për të cilët po flisnit, pa iu mbaruar karburanti? Dhe e dyta, si lëvizin këto trupa pa dëmtuar njëritjetrin, në orbitat e tyre? Është e pamundur të mos i admirosh!


Z. Jusuf e aprovoi atë që Mustafai ndau, duke tundur kokën.

Univeriteti i Islamit dhe Shkencave

-Tanimë kishin mbërritur në universitet. Kaluan nga porta madhështore e universitetit, e cila hapej në rrugë. Pasi kaluan kufijtë e universitetit, filluan të shikonin përreth më me kujdes. Kishte shumë godina brenda kampusit. Godina të mëdha të veshura me xham, zona të gjelbra, të mëdha e të gjera, rrugë të gjera që të çojnë në fakultete të ndryshme... Dhe në veçanti studentë, më të mëdhenj në moshë se ata... Ky nuk ngjante as me shkollën fillore, as me shkollën 9-vjeçare dhe as me gjimnazin. Po ecnin drejt sallës, ku do të bëhej konferenca, duke ndjekur tabela drejtuese. Kjo sallë e konferencave ndodhej ngjitur me bibliotekën. Kjo bibliotekë, edhe pse nga larg, e impresionoi shumë Betylin, një nga ato që lexojnë më shumë libra në klasë. Sepse ajo ishte godina më madhështore që kishin parë në kampus. Kishte një strukturë, që vihej re menjëherë, dykatëshe, me shumë xhama dhe zgjatej për së gjëri. Kishte një strukturë arkitekturore, që të bënte kureshtar për brendësinë e saj.

Një moment, kur Betyli po shihte me habi nga dera e bibliotekës vuri re një detaj. Në derën kryesore të bibliotekës

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



shkruhej urdhri i parë i librit tonë të shenjtë: *“Lexo, me emrin e Zotit që krijoi gjithçka.”* Betyli i tha zotit Jusuf:

-A mund të të bëj një pyetje mësues?

Z. Jusuf, me një ton të butë zëri: *“Patjetër, mund të pyesësh.”*

-Si duhet ta kuptojmë ajetin që shkruhet në hyrje të bibliotekës? U bëra kureshtarë.

Z. Jusuf:

-Të përgëzoj për vëmendjen Betyl. Shpresoj që përgjigjen e kësaj pyetjeje ta marrim në konferencë. Tani ka mbetur shumë pak kohë nga programi. Nëse dëshiron, le t’ia lemë programit t’i përgjigjet kësaj pyetjeje.

Programi do të fillonte në orën 10:00. Salla ku do të bëhej konferenca, po mbushej dalëngadalë. Salla ishte vërtet shumë e bukur. Ndriçimi dhe ajrosja ishin një mrekulli. Skena dhe

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

podiumi dukeshin qartë nga çdo karrige. Asnjëri nuk e pengon tjetrin, nuk ia zë fushëpamjen. Fëmijët po flisnin me njëri-tjetrin dhe po tregonin habinë, kush duke thënë: “Mrekulli” e kush duke thënë: “Një sallon madhështor.”

Ali Xhani:

-Si qenka këtu mësues?! Sa mirë që erdhëm!

Z. Jusuf: “Prit njëherë Ali Xhan, se programi s’ka filluar akoma. Mendimet do t’jua marr pas programit.”-tha.

Nxënësit që kishin ardhur nga shkolla të tjera 9-vjeçare, po hynin në sallë. Z. Jusuf u dha dorën dhe bisedoi me disa nëpunës. Z. Jusuf dhe nxënësit e tij, u ulën në rreshtin e dytë, në pjesën e rezervuar për ata. Pritën edhe pak sa të rregullohej sistemi i zërit dhe të organizohej salla. Prezantuesi po dukej. Të gjithë po prisnin të emocionuar.

Prezantuesi, duke filluar fjalimin me Bismil-lah, ofroi vazhdimësinë e programit. Programi u fillua me këndim Kurani. Ai që po këndonte Kuranin ishte i riu që fitoi çmimin e parë në konkursin ‘Këndimi më i bukur i Kuranit’. Po këndonte një pjesë nga surja Isra, e përshtatshme me kuptimin e temës së konferencës. Meali (kuptimi) i pjesëve që lexonte shfaqej në ekranin e madh të skenës, në gjuhën arabe, në gjuhën turke dhe në atë angleze. Në ekran ishte meali i këtij ajeti: “Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbihë), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre (pse nuk është në gjuhën tuaj). Ai është i butë dhe fal shumë.”² Ky ajet kishte tërhequr vëmendjen e të gjithëve. Ajeti tregonte se çdo krijesë e madhëronte Zotin duke e përmendur dhe duke e falënderuar.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Shkenca dhe Islami janë një e tërë

Më pas u këndua himni dhe i erdhi radha fjalimit të hapjes. Fjalimin do ta mbante rektori i universitetit. Rektori e nisi fjalimin duke u thënë miqve: “Mirë se keni ardhur.” dhe e vazhdoi kështu:



-Fëmijë të dashur! Fëmijëria ime ka kaluar në Çukurova. Pa më thoni, çfarë kultivohet më shumë në Çukurova? I gjithë salloni jehoi në një zë: “Pambuk.”


Po, e gjetët, pambuk. Kështu, edhe ne ishim një familje që zakonisht merreshim me bujqësinë e pambukut. Dua që me juve të mendojmë mbi bimën e pambukut.

Kur unë isha fëmijë mendoja. Si del nga toka e zezë një pambuk, që është lënda e parë e tekstitit, i butë, i bardhë akull dhe delikat? Kjo ndodhi më shtynte të çuditesha. Vallë çfarë ka nën tokë që, dheu kthehej në pambuk të bardhë? A mos kishte fabrikë bojërash nën tokë?

Dhe si mundej që fibrat e holla si tel të pambukut të dalin nga toka e ngurtë dhe e vrazhdë? E dini, që lënda e parë e pëlhurës është pambuku. A mund ta dijë toka, nga e cila del pambuku, se ç’është pëlhura apo ç’janë rrobat? Për më tepër,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

nga bërthamat e pambukut bëhet vaj ushqimi. Vaji që nënat tona përdorin në kuzhinë është vaj pambuku. Vallë mos ka fabrikë vaji nën tokë? Nga e mësoi toka se si bëhet vaji i pambukut, i cili është mjaft i dobishëm për shëndetin? A mund ta dijë toka ç'është shëndeti? Ja këto pyetje mendoja... Për t'u bërë pambuku duhet të bashkëpunojnë toka, uji, dielli dhe klima. Fëmijëri pra, me mendjen e atëhershme thosha: "Mos ndoshta këto bashkëpunojnë me marrëveshje? Si merren



vesh për të vepruar për një qëllim të përbashkët? "Dhe më pas thosha: "Po ata s'kanë logjikë e as ndërgjegje që të veprojnë kështu. Këta nuk mund ta dinë nevojën e njeriut për bluzë pambuku. Nuk mund ta dinë vajin që na duhet për të skuqur patate..."

Po nxënës të çmuar! Njeriut i plotësohen të gjitha nevojat nga aty ku nuk e pret. Po ta mendojmë këto nevoja mund të plotësohen në dy mënyra. Ose do themi që lëndët e pajeta, toka, uji, dielli, klima na njohin, na duan neve, u vjen keq për nevojat tona dhe na japin gjërat për të cilat kemi nevojë. Ose, e dyta; do themi që ekziston një Zotërues Fuqiplotë që, na do, na njeh dhe na mëshiron; ai Zotërues na i plotëson nevojat në kohë, pa harruar dhe pa u ngatërruar. Pra, në fund të kësaj konference do ta marrim përgjigjen e kësaj pyetjeje.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Z. rektor qëndroi pak... Pasi pa në heshtje për pak, drejt fëmijëve tha këto fjalë, që të fusnin në mendime:

-Nxënës të çmuar, feja jonë e bukur Islami dhe shkencë janë një e tërë. Sepse universi, që është zona e studimit të shkencave, është imani gjithi një vepër arti e Allahut. Ndërsa Islami është feja që Allahu ia ka dërguar njerëzimit nëpërmjet peygamberit Muhammed (a.s.). Për këtë arsye feja dhe shkencë janë një e tërë. Dy burimet themelore të Islamit Kurani dhe Hadithet Profetike nxisin mësimin e dijes dhe lavdërojnë shumë dijetarët. Islami i jep shumë rëndësi hulumtimit dhe studimit. Islami, është feja e dijes; qytetërimi i Islamit, është imani i ndërtuar mbi dije.




TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Të gjitha shkencat si: shkencat e mjekësisë, shkencat e hapësirës, shkencat e tokës vëzhgojnë dhe studiojnë çdo objekt që ka krijuar Zoti dhe veprimet e tyre. Të gjitha shkencat ekzistojnë për të zbuluar ligjet, që Allahu ka caktuar në univers. Çdo shkencë lajmëron dhe tregon për Allahun, në gjuhën e saj të veçanta. Këtë gjuhë do ta dëgjojmë nga folës të ndryshëm gjatë konferencës. Për këtë arsye ne, kur vëzhgojmë universin, që është vepra e Allahut, nuk duhet të harrojmë pronarin. Duke u nisur nga veprat e dukshme të Tij, duhet ta njohim Zotin tonë, i cili nuk duket, me iman. Unë ju uroj sërish mirëseardhjen. Duke ju dhënë lajmin e bukur se konferenca të tilla me tema të ndryshme do të vazhdojnë, ju uroj të gjithëve një jetë të suksesshme. Qofshi me shëndet.

Z. rektor u ul në vendin e tij me duartrokkitje. Prezantuesi duke thënë: “Tani ftoj në skenë folësin, një nga profesorët e shkencave teknologjike dhe inxhinierike zotin Doc. Dr. Erdem. Urdhëroni profesor i nderuar!”-ia dha fjalën z. Erdem.

Mendja vepron me prova

Fëmijë të dashur, ejani të ndajmë së bashku një përvojë jete. Për shembull, jemi pranë një mali. Po shohim që pas malit po del tym. Kur shohim këtë pamje themi: “Atje ka një zjarr.” Megjithëse nuk e shohim zjarrin, tymi që del prej andej është provë për ekzistencën e zjarrit. Pak më pas, kur të ngjisim malin dhe ta shohim me sy zjarrin, niveli i njohurisë rritet edhe pak.



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Në fund, po të shikojmë pranë zjarrit dhe të përfitojmë prej tij, të ngrohemi, atëherë njohuria jonë për ekzistencën e zjarrit arrin nivelin më të lartë.

Ashtu si këtë, kur shikojmë një godinë e pranojmë ekzistencën e inxhinierit të saj. Edhe pse nuk e shohim inxhinierin me sytë tanë, veçoritë e godinës janë provë për ekzistencën e inxhinierit. Kur dëgjojmë një këngë e dimë me siguri që, notat e muzikës nuk do radhiteshin në mënyrë të rastësishme. Këto janë të vërteta që i arrijmë duke menduar. Sepse mendja, kërkon prova dhe dëshmi për tu bindur.



Fakti që krijuesi nuk shihet, nuk do të thotë se ka ndodhur rastësisht.

Nxënës të dashur, kur shohim një ndërtesë të bukur, një nga gjërat e para që jemi më shumë kureshtarë, është se kush e ka ndërtuar atë, apo jo? Për shembull, kur shohim ndërtesa të mrekullueshme si: xhamia Sulejmanije dhe saraji i Dollmabahçesë jemi kureshtarë të njohim arkitektët e tyre. Sepse me mendjen tonë e dimë që këto ndërtesa, është e pamundur të bëhen vetvetiu.

Fëmijë të dashur! Tani po ju pyes të gjithëve, a mund të bëhet vetvetiu kjo sallë konference. Nga salla u ngritën zërat: “Jooo.” Më shumë u dëgjua zëri i Ali Xhanit.

Nëse dikush pretendon që kjo sallë është bërë vetvetiu, a nuk do të dyshonit në mendjen e tij? Salla jehoi sërish me një gojë: “Po, do të dyshonim.”

Z. Erdem, nga fëmijët që ishin ulur në pjesën e parë, thirri Hasanin në skenë. E pyeti Hasanin se si quhej dhe tha: “Hasan

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

i dashur! Nëse dikush pretendon se kjo sallë konference është ndërtuar rastësisht, çfarë do të bëje?”

Hasani:


-“Një ndërtesë e bukur si kjo duhet ta ketë patjetër një ndërtues, do t’i thosha. Një godinë e tillë nuk krijohet rastësisht. Do t’ju prezantoja nëse do ta njihja inxhinierin e kësaj godine.”-u përgjigj.

Z. Erdem e falënderoi Hasanin, e përcolli në vendin e tij dhe e vazhdoi fjalën kështu:

-“Nxënës të çmuar, unë jam edhe arkitekt edhe inxhinier ndërtimi. Kam marrë mësim në të dyja fushat.” -dhe filloi të buzëqeshte. Meqë ra fjala, inxhinieri që donte të prezantonte Hasani jam unë. Ne inxhinierët para se të ndërtojmë një godinë, bëjmë projektin dhe planifikojnë gjithçka deri në detajin më të vogël. Ne kur po ndërtonim sallën jemi frymëzuar nga Bota jonë. Nga Bota jonë, ku si njerëz jetojmë lirisht në të... Ndriçimin, ajrosjen, qëndrueshmërinë, strukturën, sistemin e zërit, të gjitha këto jemi munduar t’i bëjmë duke parë strukturat e mrekullueshme të Botës sonë.

Për këtë, para se të bënim sallën menduam se për çfarë qëllimi do të shërbejë. Vendosëm se sa duhet të ishte madhësia. Planifikuam ajrosjen në mënyrë që gjatë verës të jetë freskët dhe gjatë dimrit të jetë ngrohtë. Ashtu si stinët. Bëmë llogaritje të vendeve dhe të ndriçimit, në mënyrë që skena të shihet me lehtësi nga çdo karrige në sallë. Më pas dizajnuam me art brendësinë, muret dhe dyshemenë. Treguam shumë kujdes për sistemin e zërit që shpërndahet në çdo anë të sallës. Veçanërisht, morëm masa të veçanta për tërmetet dhe zjarret që mund të bien. Ne arritëm ta bënim këtë sallë konference me llogari inxhinierie shumë të detajuara.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Bota jonë është si një saraj i mrekullueshëm!

Tani, të mendojmë të gjithë së bashku, a nuk është si një ndërtesë edhe Bota jonë, në të cilën jetojmë? Madje si një saraj vezullues. Pra, qielli i kaltër që është tavani i këtij saraji, gjatë ditës shkëlqen ndritshëm prej diellit e gjatë natës prej hënës dhe yjeve.

Ndërsa dyshemeja, është zbukuruar me lule dhe pemë nga një cep deri në cepin tjetër; është faqja e dheut e gjallëruar me gjallesa.

Dielli jonë është si drita dhe soba e sarajit. Fëmijë të çmuar, a ka ndonjëri prej jush në shtëpi apo në shkollë, llambë që qëndron varur pa qenë lidhur askund, por që rrotullohet vazhdimisht në mënyrë të rregullt?

Nxënësit:

-“Nuk kemi. Llamba duhet të fiksohet diku.” -thanë.

Z. Erdem:

-Dielli jonë, rrotullohet edhe pse është një llambë shumë e madhe. Bota jonë lëviz në hapësirë në mënyrë të vazhdueshme edhe pse është e madhe sa të mbajë në të një milion e treqind mijë trupa qiellorë, në madhësinë e saj. Ashtu siç nuk ka shtyllë nën të, as nuk është e lidhur diku. Ai rrotullohet vazhdimisht, duke i bërë edhe planetët e tjerë të rrotullohen përreth tij. Na dërgon neve dritën dhe ngrohtësinë e nevojshme. Dhe, prej nesh nuk kërkon asnjë çmim.

Erërat në botën tonë, a nuk ngjajnë me kondicionerët që, freskojnë gjallesat dhe u shpërndajnë ajër të pastër nevojtarëve? Gjithashtu erërat, zhvendosin retë e shiut nga një vend në një tjetër. Për më tepër, bëhen ndërmjetës në riprodhimin e bimëve, duke shpërndarë pluhurin e luleve në çdo anë.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Ndërsa malet kanë një tjetër bukuri. Malet që në brendësi mbartin ujëra mineralë e shërues, për të cilët gjallesat kanë nevojë, janë si shtyllat e botës.

Nxënës të dashur, dua ta përfundoj kështu fjalën time. Ashtu siç është e dukshme që, as një shtëpi e thjeshtë ose një godinë e zakonshme nuk mund të bëhet rastësisht, as bota jonë , që është si një saraj i përsosur, nuk mund të krijohet rastësisht. Nuk mund ta marrë vetvetiu këtë formë të bukur. Bota jonë është ndërtuar për ne, nga Allahu i cili me mirësitë që ka krijuar tregon se na do dhe na vlerëson. Bota prezanton Zotin me skicimin, me rregullin, me stinët, me strukturën artistike dhe me peizazhet e mrekullueshme. Ju falënderoj që më dëgjuat dhe ju uroj suksese të gjithëve. Fëmijët që dëgjuan prezantimin, po vlerësonin fjalimin duke folur me njëri-tjetrin; i shprehnin kënaqësinë njeri tjetrit duke thënë: “Sa mirë që kemi ardhur.”

Gjuha misterioze e krijesave

Prezantuesi, duke dalë sërish në skenë:

-“Tani ftoj një tjetër folës në skenë, për të mbajtur fjalimin me temë “Gjuha misterioze e krijesave”-tha.

Profesoresha e komunikacionit del në skenë dhe e fillon fjalën duke thënë:

-Nuk besoj të ketë mesazh nga ata që nuk e kanë dëgjuar fjalën “komunikim”.

Komunikimi zë një vend të rëndësishëm në jetën e secilit prej nesh. Ne, njerëzit i përcjellim mendimet dhe ndjenjat duke i shprehur me fjalë ose jo. Komunikimi verbal; është komunikimi që zhvillojmë me anë të të folurit, fjalëve dhe gjuhës. Ndërsa komunikimi joverbal; është komunikimi që zhvillojmë me gjuhën e trupit dhe veprimet tona. Për shembull,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

buzëqeshja kur takohemi me dikë tregon kënaqësinë dhe sinqeritetin.

Fëmijë të çmuar, mund ta kuptojmë nëse një njeri është i lumtur apo i Palumtur, i gëzuar apo i hidhëruar, i emocionuar apo i qetë, duke i parë fytyrën, gjuhën e trupit dhe sjelljen në atë moment. Ky person tregon shumë gjëra me gjuhën e trupit, edhe nëse nuk e shpreh me fjalë. Përsëri, këmisha e bardhë dhe stetoskopi i një doktori, pelerina që vesh një avokat gjatë seancës gjyqësore, veshja ushtarake dhe arma në brez e një komandanti, tregojnë më së miri detyrën e tyre pa qenë e nevojshme shprehja me fjalë.

Nxënës të dashur, nganjëherë ndodh që njeriu tregon shumë gjëra duke heshtur, me gjuhën e veprimeve. Mund të marrë një përfundim më të mirë duke zgjedhur heshtjen, se sa të folur. Të parët tanë e kanë përcaktuar vlerën e gjuhës së veprimeve duke thënë: “Nëse fjala është serm, heshtja është flori.” Nëse do të vërenim me kujdes, do të shihnim që elementët e komunikimit joverbal janë mjaft të shumtë.



Për shembull, çdo tabelë që na hasin sytë, të gjitha shenjat paralajmëruese, tabelat e qarkullimit, madje edhe ngjyrat tregojnë diçka me gjuhë joverbale. Komunikojnë me ne. Karikuesi i telefonit me gjuhën e veprimeve na përcjell informacionin: “Mund të karikosh baterinë me mua.” Në fakt,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

ai mjet karikimi tregon diçka edhe duke mos karikuar çdo lloj telefoni. Një taksistë e verdhë që kalon në rrugë, jep mesazhin që: “Me mua mund të shkosh nga në një vend, në një tjetër.” Një orë e varur në mur, flet me ne, në mënyrë joverbale duke na treguar orën dhe na rikujton kalimin e kohës.

Po të jap mesazhe ne gjuhën e veprimeve, a je në dijeni?

Të dashur nxënës, ashtu si këto të gjitha krijesat kanë veçori të komunikojnë me ne, nëpërmjet gjuhës së veprimeve. Këto veçori, atyre ua ka dhënë Allahu i Lavdëruar. Sa e thjeshtë është ta kuptojmë dhe të merremi vesh me një njeri që ia dimë gjuhën. Pra, nëse do të mund ta mësonim gjuhën e krijesave në univers, do ta kuptonim me shumë lehtësi se çfarë do të na thotë krijuesi nëpërmjet atyre krijesave.

Të gjitha krijesat janë ndërmjetëse të mesazheve që Allahu dëshiron të na japë neve. Ata flasin me ne me veprimet e tyre përkatëse. Na tregojnë dhe na prezantojnë Allahun, krijuesin e tyre. Kësaj, si koncept quhet komunikimi me “gjuhën e veprimeve”. Krijesat na tregojnë Zotin me veçoritë që kanë dhe nuk kanë. Për shembull, fakti që duket sikur po e bën një i paditur, një punë që kërkon dije, është një gjendje që duhet menduar mbi të. Sepse një person që nuk ka dije, me paditurinë e tij në këtë aspekt, arrin të tregojë që nuk e ka kryer vetë këtë punë.

A nuk na tregon diçka neve fakti që një person i pafuqishëm arrin të bëjë gjëra, për të cilat duhet shumë fuqi? Pafuqia e tij, tregon se atë punë, për të cilën duhet shumë fuqi, e ka bërë dikush tjetër. Kur shohim që një vepër arti, e ka bërë një person që nuk ka njohuri mbi artin dhe bukurinë, duhet të mendojmë se jemi përballë me një gjendje, të cilën duhet ta studiojmë më me kujdes. Kështu, secila prej krijesave me gjuhën e veprave: “O njeri! Po të jap mesazh me gjuhën e veprimeve, je në dijeni?”-thotë.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS


Për shembull të dashur nxënës, bleta, e cila është një insekt helmues, na jep mjaltë të ëmbël e shërues, është një mesazh. Një lule me gjuhën e veprimeve jep mesazhe si: “Bukuritë mbi mua, mund të krijohen vetëm nga Allahu.

Krijuesi i tokës, ujit, dritës më ka krijuar dhe mua me to. Unë, ashtu si shoqet e mia lule, jam provë e ekzistencës, njëshmërisë dhe mbiemrave të Krijuesit. E Atij që është toka, të Atij jemi dhe ne që kemi dalë nga toka. Të gjitha lulet si unë në botë, marrim rreze nga i njëjti diell, përfitojmë nga e njëjta klimë, ai që është zotëruesi i diellit është

edhe zotëruesi jonë. Pra fëmijë të çmuar, një njeri që sheh me nurin, pra dritën, e imanit vë re që të gjitha krijesat në univers flasin me ne, me një gjuhë përkatëse dhe mund ta mësojë këtë gjuhë të universit.

Ju falënderoj që më dëgjuat me interes. Ju uroj një jetë të lumtur e të suksesshme.

Duartrokitjet ishin shtuar sërish. Fëmijët kishin vënë re të vërtetën që krijesat mund të komunikojnë pa fjalë, në mënyrë joverbale me njeriun. Radhën e kishte prezantimi i profesorit të arteve. Para këtij prezantimi kishin 30 minuta pushim. Nxënësit ishin kureshtarë për prezantimin e folësit të radhës. Mbanin shënime të rëndësishme nga të gjithë folësit dhe mundoheshin të dëgjonin me vëmendje.



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Një punë që kërkon dije, nuk e bën një i paditur

Në pushimin e dhënë, u ngjitën të gjithë së bashku në holl. Një pjesë e nxënësve, duke marrë leje nga z. Jusuf, u drejtuan drejt makinerisë automatike të ushqimeve dhe të pijeve, në cepin e djathtë të hollit. Ishin të etur, kishin dhe pak uri. Makinaria ishte e mbushur me pije dhe ushqime si: ujë, biskota, lëngje. Në momentin që hidhje lekë të holla në vendin përkatës dhe shtypje numrin e produktit, pija ose ushqimi merrej në pjesën e poshtme të makinerisë. Ndërsa z. Jusuf po i shikonte nga larg. Z. Jusuf u tha nxënësve të tjerë pranë tij:

-Ejani të shkojmë pranë shokëve tanë. Shkuan së bashku pranë makinerisë. Në shkollën e tyre nuk kishte një makineri të tillë. Një pjesë e nxënësve e studiuuan me kujdes makinerinë.

Z. Jusuf:

-Kjo makineri, a mund të jetë shembull i komunikimit joverbal, që shpjegoi profesori pak më parë?

Muštafai:

-Po mund të jetë mësues, sepse kjo makineri automatike me gjuhën e veprimeve thotë: “Nëse kërkoni nga unë ujë ju jap ujë, nëse kërkoni biskota ju jap biskota, nëse kërkoni çokollatë ju jap çokollatë.”

Z. Jusuf

-E drejtë, ka dikush ndonjë mendim tjetër?

Betyli:

-Mësues, kjo makineri nuk është e ndërgegjegjshme apo e vetëdijshme. Nga ta dijë nevojën tonë për ujë dhe ushqim? Këtë makinë e ka vënë këtu dikush që e njeh njeriun dhe i di nevojat e tij.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



Kujdestari i klasës, Saiti:

-Mësues, nëse askush nuk e mbush me produkte, kjo makinë nuk na jep dot asgjë.

Z. Jusuf:

-Shumë e vërtetë. Të gjithë paskeni kuptuar vërtet komunikimin joverbal, me gjuhën e veprimeve. Siç tha profesori pak më parë: “Fakti që një punë që kërkon dije duket sikur e bën një person i paditur, është një gjendje që duhet të mendojmë mbi të.” Ndërkohë, tani po shuajmë etjen nëpërmjet makinerisë. A mund të jetë kjo makineri e pajetë ajo që na jep ujë e na qetëson? A mund ta dijë kjo makineri e pandjeshme nevojën tonë për të shijuar diçka? Patjetër që nuk mund ta dijë. Atëherë, a nuk duhet ta kërkojmë burimin e kësaj? A nuk është e njëjta situatë edhe në tokë? Nga ta dijë toka që ne jemi të uritur? Vallë a mund ta dinë toka dhe uji që, duke na dhënë grurë do të ngopemi dhe do të ndjehemi të lumtur?

Fëmijë, të gjithë në një zë:

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Patjetër që nuk e dinë mësues, sepse nuk kanë një aftësi të tillë.

-E vërtetë, ata janë vetëm një ndërmjetës. Vetëm ndërmjetës që ndërmjetësojnë ardhjen e mirësive nga thesari i mëshirës... Allahu çdo vit, në stinën e pranverës dërgon mirësitë nga thesari i mëshirës. Degët e pemëve, të cilat gjatë dimrit janë të thata si skelet, në pranverë Ai i mbush plot me fruta. Kjo ndodh kështu çdo vit. Sepse thesari i mëshirës së Allahut, është i pafundmë dhe nuk mbaron. Kurse, nëse këtë makinerinë nuk e mbush dikush, ajo nuk do të na jepte asgjë vetvetiu. Nga nxënëset, Rejana pyeti:

-Mësues, edhe bankomatët që tërhiqen para ashtu janë, apo jo?

-Po, edhe ata ashtu janë Rejana. Asnjë bankomat nuk e di nevojën që keni për para. Nuk mund të jetë puna e krijesave të pandërgjegjshme dhe të pandjeshme të dinë nevojat. A mund të na japë para bankomati, nëse dikush nuk e mbush atë me para?

Nuk mund të ketë pikturë pa piktor

Pushimi kishte mbaruar. Nxënësit zunë sërish vendet e tyre në sallë. Prezantuesi doli sërish në skenë dhe ftoi profesorin e arteve. Profesori, që dukej se ishte rreth të pesëdhjetave, u ngjiti në skenë i shoqëruar me duartrokitje dhe filloi të fliste me ngadalë. Tha se nuk do të fliste në foltore, por duke bërë ece-jake në skenë. Dhe në ekranin e madh të skenës u shfaq një imazh.

Në imazh ishte një pikturë me bojëra vaji. Në këtë pikturë kishte flutura të ndryshme, ngjyra-ngjyra, të cilat fluturonin mbi lule. Kur profesori i arteve tha: “Dua të ftoj në skenë një nxënës vullnetarë prej jush. Kam dëshirë ta komentojmë me atë këtë

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

pikturë.”, piktorja e klasës, Rejana, ngriti dorën menjëherë. U panë në sy me profesorin. Profesori i arteve, e ftoi atë duke i thënë: “Urdhëroni!”, duke përfutur pak edhe nga përparësia e të qenit afër skenës. Rejana ishte emocionuar. Ishte shumë bukur të pikturoje, por vallë si do të ishte të komentoje një pikturë, sidomos me një profesor universiteti? Me mendime të tilla në kokë, përparoi drejt skenës shpejt e shpejt. Arriti pranë profesorit. Fillimisht profesori e përgëzoi atë për vetëbesimin. Më pas, duke i pyetur emrin i tha të ishte e qetë.

-Po Rejana, tani le ta vlerësojmë së bashku këtë pikturë. Çfarë na tregon neve piktura? Ta komentojmë së bashku.

- Në rregull, ta provoj. Shoh flutura të pikturuara mbi kanavacë. Secila prej fluturave është shumë e bukur, e ndryshme nga të tjerat dhe artistike. Në sfond ka një qiell të hapur, lule shumëngjyrëshe dhe pemë. Fluturat po enden fluturimthi. Për më tepër, ka një paletë vizatimi. Mbi të shoh bojëra të ndryshme dhe furça me madhësi të ndryshme.

-Përshkruan shumë bukur Rejanë. Sipas teje, a mund të bëhet vetvetiu kjo pikturë?

-Joo. A mund të ndodhi një gjë e tillë?! Këtë pikturë të bukur mund ta bëjë vetëm një piktor i talentuar. Madje, piktori paska hedhur firmën e tij në fund të pikturës.

-E vërtetë. Piktori ka edhe një firmë që i lexohet emri. Pa dyshim, këtë pikturë e ka bërë një piktor. Sepse asnjë pikturë nuk është pa piktor. Asnjë statujë nuk bëhet vetvetiu. Kjo pikturë e bukur është bërë nga një piktor i aftë, si rrjedhë e talentit dhe e ndjenjave të tij. Rejanë e dashur, dua të të pyes edhe një pyetje tjetër. Sipas teje, a mund të kenë krijuar bojërat në pikturë, këto figura të ndryshme të fluturave duke spërkatur rastësisht majtas e djathtas?

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Jo, nuk munden.

-Pse?

-Sepse nga bojërat e spërkatura rastësisht, nuk del një formë e rregullt. Po bojërat s'kanë as një aftësi të tillë...

-Urime Rejana, e the shumë mirë. Bojërat e pajeta që janë përdorur në bërjen e pikturës, nuk mund të jenë piktorët e saj. Ndërkohë as në penelat e përdorur për të pikturuar nuk e kanë talentin e piktorit. Gjithashtu letra e kanavacës është shumë larg të qenit piktores.

Profesori i arteve, tani filloi të tregonte duke u kthyer nga salla.

-Nxënës, nëse më lejoni, fillimisht dua t'ju rrëfej diçka. Ata që ishin në sallë u bënë kureshtarë. Veçanërisht Rejana u bë shumë kureshtarë.

Profesori vazhdoi:

-Ndonjëherë edhe unë vizatoj piktura fluturash. Marr përballë një flutur dhe e shikoj. Filloj të vizatoj pasi ta kem shqyrtuar atë. E filloj vizatimin nga njëri krah i saj. Kurse, kur vizatoj krahun tjetër duhet ta vizatoj më me kujdes, më me vëmendje.



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Rejana me kuriozitet:

-Pse duket të jeni të kujdesshëm dhe të vëmendshëm kur vizatoni krahun tjetër?

Profesori u përgjigj me buzëqeshje:

-Sepse kur vizatoj krahun tjetër të fluturës, e vizatoj duke matur krahun e mëparshëm dhe duke e parë atë. Kjo kërkon kujdes dhe vëmendje, se në të dyja krahët e fluturës ka një simetri, një rregullsi dhe një matje të mrekullueshme.

Kur profesori i arteve po shpjegonte këto piktorja e vogël Rejana, me eksperiencën që i ka kishte dhënë marrja me pikturë, i konfirmonte fjalët e profesorit duke tundur kokën.

Subjekti nuk është prej llojit të objektit

Profesori i arteve e përcolli Rejanën në vendin e saj duke e falënderuar.


-Në rregull, nxënës të dashur, të gjithë e kuptuam që nuk ka pikturë pa piktor, nuk mund të ketë! Sepse kur shqyrtojmë procedurën e përfundimit të një pikturë, kemi përballë një pikturë dhe një subjekt që e ka bërë atë. Piktura është objekti, pra krijesë që punohet mbi të. Ndërsa piktori është subjekt. Pra, ai që vizaton, ngjyros dhe mat, një person me aftësi mbi një nivel të caktuar. Një piktor mund të ekzistojë pa pikturë, por një pikturë nuk mund të bëhet kurrë pa qenë një piktor. Një tjetër pikë e rëndësishme është, që piktori nuk është prej llojit të pikturës. Pra subjekti nuk është prej llojit të objektit. Subjekti duhet të ketë veçori të ndryshme, të nivelit më të lartë. Një piktor duhet të ketë dije dhe aftësi për t'i zbatuar si: dritë-hija, pamja vizuale, mendimi tredimensional, përputhje ngjyrash, për të matur dhe vizatuar. Këto aftësi nuk i ka as piktura, as peneli e as boja.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Sërish, po të mendojmë një statujë, është e njëjta gjë. As një statujë e zakonshme nuk mund të bëhet vetvetiu. Dhe , asnjë statujë nuk e ndërton dot veten. Unë jam profesor i arteve. Deri në sot, nuk jam parë penela dhe bojëra që bëjnë piktura vetë, pa qenë një piktor i logjikshëm dhe i gjallë. Nuk kam rastisur në një çekiç që mund t'i gdhendi vetë veturat. As nuk jam takuar me ndonjë që ka rastisur.

Profesori e vazhdoi fjalën kështu:

-Atëherë, ejani të mendojmë fluturën e vërtetë së bashku. Po, një flutur e vërtetë fluturon, merr frymë, ka sistem frymëmarrjeje, i lëvizin krahët, është e shkathët. Ka një sistem qarkullimi të gjakut, duke qenë se i lëviz krahët vazhdimisht, ka nevojë për një sistem që pompon gjak. Ndërsa për t'u rritur e për tu zhvilluar ka nevojë për një sistem tretjeje. Gjithashtu, ka nevojë për shumë organe që të vazhdojë jetesën, veçanërisht për të krijuar lidhje me universin dhe për të kërkuar furnizimin e saj. Edhe vizatimi i pajetë mbi një fletë i një fluturë mund të bëhet vetëm nga një piktor mjeshtër, apo jo? Në qoftë se është kështu, si mund të mendohet që flutura e gjallë, e lëvizshme është krijuar pa qenë një krijues?



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Ja pra, përgjigjen e kësaj pyetjeje do t'jua japë një miku im nga departamenti i shkencave. Unë dua t'ia lë atij fjalën. Ju falënderoj që më dëgjuat me interes. Qofshi me shëndet.

Prezantuesi u duk sërish në skenë. Falënderoi profesorin e arteve për fjalimin e bukur dhe ftoi në skenë profesorin e shkencave natyrore. Profesori i shkencave të natyrës ishte i moshuar por dukej i fuqishëm. Me zërin e tij të kumbueshëm përshëndeti sallën dhe shfaqti një shkrim në ekran. Në ekran shkruhej diçka që ishte e vështirë të kuptohej.

!Rëtshejm tehud sërutulf e nimitaziv rëp ehde

Profesori pyeti të gjithë sallën:

-Sipas jush çfarë shkruhet këtu? Të gjithë po shikonin shkrimin por askush nuk përgjigjej dot. Papritur një djalë nga një shkollë tjetër, i ulur në rreshtat e parë tha: “Unë e gjeta.” Profesori i shkencave të natyrës i dha fjalën duke i thënë: “Urdhëro bir.”

Djali tha:

-Zotëri, shkruan “Edhe për vizatimin e një fluture duhet mjeshtër!”

Vërtet ashtu shkruhej. Profesori përgëzoi djalin duke i thënë: “Të lumtë biri im!” dhe e vazhdoi kështu fjalën:

-E shkrova këtë fjali mbrapsht për të tërhequr vëmendjet tuaja. Ju lumtë, e gjetët menjëherë. Fëmijë dua ta vazhdoj temën aty ku e la miku im. Fluturat, shkencërisht ndahen në dy grupe. Fluturat e ditës dhe fluturat e natës. A e dini që fluturat kanë rreth njëqind e pesëdhjetë mijë lloje? Një flutur e gjallë, shumëngjyrëshe, fluturuese ka shumë lidhje me vendin ku jeton. Për shembull, fluturat e ditës kanë nevojë për diell, për të gjetur rrugën dhe drejtimin e tyre. Të gjitha fluturat kanë lidhje me

TË SHOHESH PREJ MOLLËS


forcën e gravitetit për të fluturuar me lehtësi. Kanë një afrimësi interesante me lulet dhe polenin. Fluturat, të cilat zakonisht jetojnë 1-2 muaj, nuk marrin mësim fluturimi në asnjë vend. Fluturojnë në mënyrë të përsosur, pa i ditur ligjet e fluturimit. Veçanërisht fluturat e natës, kanë sistem nuhatje dhe sistem dëgjimi të ndjeshëm dhe të përsosur. Disa lloje mund të nuhasin aromën e një fluturë tjetër, në largësi 5 km. Po nxënës të dashur, edhe ai që do të bëjë, të krijojë fluturën duhet të ketë veçoritë që përmendëm pak më parë. Fillimisht duhet të dijë habitatin ku jeton flutura, mjediset me të cilat ajo është e ndërthurur dhe sipas kësaj duhet ta krijojë atë. Sepse flutura mund të jetojë në atë sistem, në atë mjedis. Duhet të dijë raportin mes fluturës dhe diellit edhe mes fluturës dhe forcës së gravitetit. Një që nuk i di këto, nuk mund të jetë zotëruesi dhe krijuesi i fluturës.

Nxënës të çmuar, krijesat si fluturat, insektet nuk krijohen vetëm nga një. Krijohen aq shpejt dhe shumë sa nuk i numërojnë dot. Megjithëse krijohen shumë shpejt dhe të shumta në numër të gjitha kanë një përsosmëri dhe bukuri të njëjtë. Janë të gjitha si një vepër arti.

Çdo gjë është e ndërlidhur me gjithçka!

Fluturës duhet t'i ofrohet gjithçka në shërbim çdo gjë që i nevojitet asaj, në mënyrë që të mund të jetojë, të ushqehet dhe të fluturojë. Pra, i kujt është dielli, e atij është edhe flutura. Ai që nuk është zotëruesi I diellit, nuk ia mundëson dot asaj shikimin. Sepse flutura ka nevojë për diellin. Fluturimi, shikimi, vazhdimësia e jetesës së një gjallesë është e lidhur me faktorë të panumërt. Ai që nuk i di këto faktorë nuk mund ta krijojë atë flutur. Krijuesi i fluturës duhet të krijojë edhe çdo gjë që i duhet fluturës për të jetuar. Ai që ka krijuar syrin e fluturës, ai ka krijuar edhe sistemin e diellit. Sepse një gjë, është në kontakt me çdo gjë në univers.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



Një i pjetë nuk mund të japi jetë!

Këtë dua ta shtjelloj pak. Për shembull cilësia më e pikasur i një fluturë të lëvizshme është të qenit e gjallë. Jeta është një cilësi e jashtëzakonshme. Mendoj se ai që jep një cilësi të jashtëzakonshme, duhet të ketë shumë aftësi të jashtëzakonshme. Për këtë arsye, që një gjë e bërë të jetë e gjallë duhet që edhe bërësi të ketë jetë. Si mund t'i japi jetë një gjëje, ai që është i pjetë? Për këtë arsye, klima dhe toka e pjetë, uji dhe dielli i pjetë nuk mund ta krijojnë fluturën.

Fëmijët të dashur, ai që i ka dhënë sy fluturës dhe gjallesave të tjera, duhet të jetë edhe zotëruesi i diellit. Sepse pa qenë dielli syri nuk e kryen detyrën. Ai që i ka dhënë fluturës sistemin e dëgjimit, duhet të jetë edhe krijuesi i tingujve. Nëse nuk ka tingull, çfarë pune bën veshi? Për këtë arsye, Allahu që iu ka dhënë shqisën e shikimit gjallesave, edhe vetë është Shikues.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Zoti që i ka dhënë sistëm dëgjimi të veçantë çdo gjallese, nëse nuk do të dëgjonte vetë, a do të mund të na e jepte neve këtë cilësi? A mund të mendojmë se nuk di të flasë Allahu, i cili i bën gjallesat të flasin me njëra-tjetrën në mënyra të ndryshme?

Pas duartrokitjeve prezantuesi doli sërish në skenë dhe sugjeroi diçka të tillë:

-Fëmijë të çmuar! U lodhët pak, temat janë shumë të bukura. Sipas temës që profesori zhvilloi pak më parë, nga gjuha e veprimeve kuptoj që, për të dëgjuar më me vëmendje dhe më të gjallëruar kemi nevojë për pak pushim. Tani kalojmë në pushimin tridhjetë-minutësh që është në program. Do të kemi çaj dhe qerasje në holl.

Nëse në një punë përzihen shumë duar, ajo punë ngatërrohet.

Në zonën e hollit ishin ëmbëlsira dhe çaj për qerasje. Fëmijët, ishin ulur me z. Jusuf në kolltukët e pushimit në zonën e gjerë të hollit. Vëmendjet e tyre i kishin tërhequr akuariumet e vendosur në vendet e ndryshme të hollit. Njërës iu afruan dhe e shqyrtuan. Dukeshin vërtet të mrekullueshme. Në to kishte alga të gjelbra dhe peshq në ngjyra të ndryshme. Në brendësi dhe në sipërfaqe të ujit dukeshin fluska vazhdimisht.

Z. Jusuf:

-A ka ndonjë që ka akuarium dhe ushqen peshq në shtëpi?

Betyli:

-Ka në shtëpinë tonë, mësues.

-Si është? A është i vështirë kujdesi për to?

-Po, mësues, megjithatë babi kujdeset për ata. Unë e ndihmoj atë. Është një punë e këndshme.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

-Si kujdeset babi yt, a mund të na e tregosh pak?

-Mësues, ka ekuilibra shumë të rëndësishëm. Madje babi thotë: "Jeta është një ekuilibër." Për shembull, në akuarium punon një motor elektrik oksigjeni dhe pompon oksigjen të pastër në ujë. Sasia e oksigjenit nuk duhet të jetë as e tepërt as e mangët. Duhet të jetë në ekuilibër të plotë. Një herë shkuam me pushime. Motori i ajrit ishte prishur dhe peshqit kishin mbetur pa oksigjen. I kishim humbur të gjithë peshqit. Gjithsesi, edhe pastrimi i akuariumit është shumë i rëndësishëm. Ujin e pastrojmë vazhdimisht duke e filtruar me një filtër elektrik. Mbeturinat e peshqve e ndotin ujin. Ata nuk mund të zhvillohen në ujë të ndotur se sëmuren. Për këtë marrim peshq pastrues, të cilët ushqehen me mbeturinat e akuariumit, që ata ta pastronjë atë.

Veçanërisht, babi im nuk do që të përzihet një person i dytë, që të mos priset ekuilibri dhe rregulli i akuariumit. Nuk e harroj asnjëherë, një herë kushërira ime erdhi mikeshë në shtëpinë tonë. Ajo u kishte hedhur peshqve ushqim të gabuar dhe sasi të madhe, pa dijeninë e babit tim dhe u bë shkak që peshqit tonë të sëmureshin. Babi atëherë na shpjegoi kuptimin e fjalës së urtë: "Nuk mund të ketë dy krye në një vend, në të kundërt nuk ka rregull."

Z. Jusuf:

-Siç na tregove Betyl, nuk qenka e thjeshtë të kujdesesh për akuariumin?

-Mësues, s'ka mbaruar akoma. Peshqit e vegjël i ushqejmë veçmas peshqve të mëdhenj. Edhe ekuilibri i dritës në akuarium është shumë i rëndësishëm. Duhet të ketë dritë aq sa të mos shqetësohen peshqit.

Z. Jusuf:

-Kjo punë kërkon vërtet kujdes dhe vëmendje. Sa i madh

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

është akuariumi në shtëpinë tuaj, a është sa një dhomë?

Betyli:

-Joo, mësues, nuk është aq i madh. Një metër e gjysmë i gjatë dhe 70 centimetra i gjerë.

Z. Jusuf:

-E shikoni nxënës, edhe kujdesi i një akuariumi të vogël kërkon shumë vëmendje. Kërkon një kujdes të rregullt. Nevojat e peshqve duhen plotësuar në kohë. Nëse përzihet një dorë e dytë, rendi në akuarium priset.

Mirë, le të mendojmë njëherë, kush kujdeset për peshqit që gjenden në lumenj, liqene, dete dhe oqeanë? Kush e ruan ekuilibrin atje? Kush i ushqen peshqit bashkë me gjallesat e tjera atje, kush i drejton ato? Kush merret me pastrimin e tyre?

Për shembull le të mendojmë krijesat e detit që, në një rërë të zakonshme ose ujë të zakonshëm u dërgohet furnizimi në mënyrë të përkryer. Megjithëse disa peshq bëjnë miliona vezë,



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

ekuilibri i krijesave të detit nuk priset. Kush e krijon këtë ekuilibër të përsosur, kush e ruan pasi e krijon?

Të dashur fëmijë, le të mendojmë! Kur bota jonë rrotullohet me shpejtësi në hapësirë, detet dhe oqeanet nuk e pushtojnë tokën. Një sistem i përsosur vazhdon. Fakti që ky rend është i përkryer dhe vazhdon me përsosmëri, është provë që, këto punë janë krijuar dhe drejtohen nga një dorë. Nëse do të kishte një krijues të dytë, punët do të ngatërroheshin dhe rendi do të prishej. Sepse nëse në një punë përzihen shumë duar, ajo punë ngatërrohet. Drejtimi i deteve, rendi, kujdesi dhe ushqimi i krijesave brenda tij, mund të bëhen vetëm me fuqinë dhe dijen e pafundme të Zotit, që është një.

Nxënësit, duke dëgjuar shpjegimin e z. Jusuf nga njëra anë morën një gllënjë nga çaji.

I ftuari surprizë

Pushimi kishte mbaruar shumë shpejt. Nxënësit ishin kthyer të gjithë në sallë dhe po uleshin në vendet e tyre me qetësi. Ata ishin më të gjallë dhe kureshtarë për prezantimin e folësit të radhës. Prezantuesi thirri Dr. z. Jusuf, i cili kishte bërë doktoratën në degën Shkencat e Islamit, në universitetin e Islamit dhe Shkencave të Stambollit. Folësi i fundit ishte vërtet surprizë. Fëmijët edhe u habitën edhe u gëzuan. Nxënësit nuk e njihnin fare këtë anë të tij. Kur mësuesi i tyre doli në skenë, gëzimi i tyre ia vlente të shihej. Secili prej tyre u krenua me mësuesin e tyre. Duartrokitën me gëzim duke parë njeri-tjetrin dhe më pas dëgjuan z. Jusuf me veshë të hapur.

Zoti Jusuf:

-Nxënës të dashur dhe profesorë të nderuar, kurse unë dua të ndaj me ju, shkurt dhe në mënyrë të përmbledhur, katër nga

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

gjashtë kushtet e imanit. Fëmijë të çmuar, imani ka gjashtë kushte. Pejgamberi jonë (a.s.) i ka shpjeguar gjashtë kushtet e imanit duke thënë: “Besimi në Allah, në engjëjt, në librat, në pejgamberët, në ditën e kijametit dhe besimi në caktimin e Allahut.” Tani dua t’i shpjegoj gjashtë kushtet e imanit sipas radhës.

Çdo poezi tregon poetin e saj

Besimi në Allah, të dashur nxënës: do të thotë të besosh ekzistencën e Allahut, i Cili krijoi gjithçka nga hiçi, njëshmërinë dhe që Ai nuk ka shok. Çdo gjë në univers është provë për ekzistencën e Allahut. Ashtu siç, një vepër arti është dëshmi për bërësin e saj, gjithashtu, çdo gjë në univers është dëshmi për ekzistencën e Allahut, i Cili i krijoi ata. Një univers nuk mund të mendohet pa krijues, ashtu siç nuk mund të mendohet një poezi pa poet dhe një godinë pa arkitekt. Nga ana tjetër, rendi i universit dhe rregulli janë provë e njëshmërisë së Allahut. Rregulli i jashtëzakonshëm dhe rendi i mrekullueshëm që shohim, nga atomet deri tek yjet, tregon haptazi që Allahu është i Vetëm dhe nuk ka shok. Aty ku ka rregull ka unitet. Sepse nëse do të kishte dy sundues në një vend, dy kryetarë në një qytet, dy drejtorë në një shkollë atëherë, në atë vend, në atë qytet, në atë shkollë do të kishte ngatërime. Për shembull, si do të ishte të kishte shkolla juaj dy drejtorë? A nuk do të ngatërroheshin punët? A nuk do të kishte probleme nëse njëri do të kundërshtonte vendimin e tjetrit?



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Fakti që engjëjt nuk duken, nuk do të thotë se nuk ekzistojnë

Nxënës të çmuar, dua t'ju bëj një pyetje. A ka ndonjëri prej jush që ka qënë në Australi? Nëse ka, të ngrejë dorën! Në sallë nuk u ngrit asnjë dorë. Pse, ka një kontinent në botë që quhet Australi?


Të gjithë: “Po, ka.”-thanë.

Z. Jusuf:

-Nxënës të çmuar, engjëjt jetojnë në një dimension ndryshe nga njerëzit. Bota shpirtërore ku jetojnë engjëjt, është ndryshe nga bota jonë. Edhe pse nuk kemi shkuar në kontinentin e Australisë dhe nuk i kemi parë njerëzit që jetojnë atje, nuk kemi dyshim për ekzistencën e tyre. Ashtu siç vajtja dhe takimi me ta e dikujt prej nesh është një është një provë e madhe për ekzistencën e tyre. Në të njëjtën mënyrë ne, e mësojmë ekzistencën e engjëjve nga të gjitha fetë që ka zbritur Zoti, nga pejgamberët që janë takuar me ata dhe nga librat që ka dërguar Allahu.

Nxënës të çmuar, engjëjt janë krijesa që nuk duken me sy, të krijuara nga drita dhe të ndërgjegjshme. Ata kryejnë detyrat e ndryshme që Allahu iu ka dhënë. Megjithëse ata nuk duken, nuk do të thotë që nuk ekzistojnë. Sepse një pjesë të mirë të gjërave që nuk i shohim i pranojmë pa hezituat. Për shembull, ka disa organizma që dallohen vetëm me mikroskop. Ka edhe disa yje dhe planetë që dallohen vetëm me teleskop. Ne e pranojmë ekzistencën e tyre duke u besuar dijetarëve specialistë të këtyre degëve. Pra, të gjithë pejgamberët, të cilët janë të besueshmit e Allahut, duke qenë se janë specialistë në fushën shpirtërore, thonë: “Engjëjt ekzistojnë dhe janë të vërtetë, ne jemi takuar.” I bëhen provë imanit tonë.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS




Fakti që engjëjt nuk i shohim dot me sytë tanë, nuk është kusht të dyshojmë tek ekzistenca e tyre. Sepse, ka aq shumë gjëra, të cilat edhe pse nuk i shohim nuk kemi dyshim tek ekzistenca e tyre. Për shembull, ne nuk i shohim valët elektromagnetike të telefonave, por ekzistencën e tyre e pranojmë në mënyrë të prerë. Në hapësirën e ajrit gjenden shumë krijesa si: valët e radiove, valët e zërit, valët e televizorit. Por, ne as ato nuk i shohim dot. Fakti që ne nuk i shohim ato, nuk do të thotë që ata nuk janë.

Nxënës të çmuar, fakti që nuk i shohim engjëjt; do të thotë që: ‘Ata nuk na shfaqen neve përkohësisht’, në botën e përkohshme sprovuese në të cilën ndodhemi. Për më tepër, tregon që ne nuk kemi strukturë të përshtatshëm për t’i parë ata në këtë botë.

Nxënës të dashur, tani dua të flas pak për besimin në librat e Allahut. Allahu ka dërguar peygamberë për të treguar rrugën

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

e vërtetë dhe për të mësuar rregullat, të cilët do të na bëjnë të lumtur në botë dhe në ahiret. Pejgamberët, janë të dërguar për t'u përgjigjur, për t'u shpjeguar dhe për t'u njoftuar njerëzve pyetjet, të cilave ata nuk do t'i përgjigjeshin dot me logjikë. Zoti një pjesë të të dërguarve të tij u ka zbritur libra dhe një pjesë sahife (faqe). Kurse pejgamberët, të cilëve nuk u është zbritur libër e as sahife, e kanë kryer detyrën e tyre sipas librit ose sahifeve të mëparshme.



Ndërsa katër librat e mëdhenj dhe pejgamberët, të cilëve u janë zbritur, janë: Muasait (a.s.) Teurati, Davudit (a.s.) Zeburi, Isait (a.s.) Ungjillin, Muhammedit (a.s.) Kurani. Tre librat e parë nuk janë ruajtur ashtu siç i ka zbritur Allahu, por janë ndryshuar me kohën, nga njerëzit për përfitimet e tyre në këtë botë. Këto libra e kanë humbur fleshmërinë e tyre. Kurse, libri jonë i shenjtë i Kuranit, ka ardhur deri më sot pa i ndryshuar asnjë shkronjë, që nga dita që i është zbritur Pejgamberit tonë (a.s.). Kurani Famëlartë do ta ruajë vlefshmërinë deri në Ditën e Kijametit, sepse Allahu na ka premtuar.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Njerëzimi ka nevojë për pejgamberë

Pejgamberët janë njerëz model dhe udhëheqës për t'u marrë shembull, të zgjedhur mes njerëzve dhe të dërguar nga Allahu, të dashur nxënës. Historia e pejgamberëve fillon me njeriun e parë. Njeriu i parë, Ademi (a.s.) është pejgamberi i parë. Njerëzit, ashtu sic kanë nevojë për një mësues, i cili u mëson gjërat që nuk i dinë, ashtu kanë nevojë për pejgamberët, të cilët u mësojnë temat si: Imani, adhurimet, morali.

Fëmijë të çmuar, asgjë në univers nuk është pa qëllim. Sepse universi është vepra e Allahut, i cili ka mençuri të pafundme. Pejgamberët, janë të dërguar që e njoftojnë dhe e tregojnë Allahun me veprat që Ai ka krijuar. Zoti na ka njoftuar nëpërmjet pejgamberëve se përse i ka krijuar njerëzit dhe krijesat e tjera dhe se çfarë kërkon nga ata. Ata të dërguar, janë bërë shembuj me jetesën e tyre të adhurimeve, të moralit dhe të jetës shoqërore, për të cilat Allahu i ka njoftuar ata.

Ne kemi nevojë për doktorë, për t'u kuruar dhe për të qenë të shëndetshëm. Në të njëjtën mënyrë, kemi nevojë për pejgamberë, të cilët janë doktorë shpirtërorë, për të kuruar problemet shpirtërore dhe trupore dhe sëmundjet personale e shoqërore.


Pejgamberët flasin për qëllimin e njeriut në këtë botë dhe i bëjnë njerëzit me dije për të vërtetat, që Allahu i ka njoftuar ata. Qëllimin e krijimit dhe kuptimin e njeriut në këtë botë mund ta mësojmë vetëm se nga pejgamberët. Ata i mësojnë njerëzimit se çfarë duhet të bëjnë, mënyrën dhe veçanërisht arsyen e bërjes së veprimeve që do të bëjë. Gjithashtu, se çfarë fiton nëse i bën dhe çfarë humb nëse nuk i bën, ata mund ta mësojnë vetëm nëpërmjet pejgamberëve të bekuar.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



Pejgamberët janë të dërguar, të cilët Allahu i ka zgjedhur mes njerëzve. Allahu i Lavdëruar flet me pejgamberët me anë të shpalljes. Ai u ka dhënë të dërguarve të Tij mrekulli, për të vërtetuar që ata janë pejgamberë. Mrekullitë, janë gjëra të jashtëzakonshme, të cilat i janë dhënë pejgamberëve dhe nuk mund të krijohen të ngjashme nga askush tjetër. Për shembull: zjarri që nuk e dogji Ibrahimin (a.s.), shkopi që u shndërrua në gjarpër i Musait (a.s.); ndarja në dy pjesë e hënës me lëvizjen e gishtit të Profetit tonë, Muhammedit (a.s.), rrjedhja e ujit nga gishtat, janë disa nga mrekullitë.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



Do të ketë jetë Ahireti

Të dashur fëmijë! Besimi në ahiret do të thotë, të besosh në botën e pafundme që do të fillojnë pas Ditës së Kijametit. Kjo botë është një vend sprove. Njeriu është dërguar në këtë botë për një detyrë. Jeta e kësaj bote, është një stacion i vogël i një udhëtimi të gjatë. Njeriu është një udhëtar. Niset nga bota e shpirtrave për në barkun e nënës, nga fëmijëria në rini dhe nga rinia drej pleqërisë. Më pas nga pleqëria në varr, nga jeta e varrit në vendin e ringjalljes dhe nga aty udhëton drejt xhenetit të përjetshëm. Në këtë udhëtim jeta e kësaj bote është shumë e rëndësishme. Mënyrën se si do ta jetojmë jetën e përjetshme, e përcaktojmë me veprat që bëjmë në këtë botë. Sepse kjo botë është toka e ahiretit. Njeriu çfarë të mbjellë këtu, atë do të korrë në ahiret. Ne, ashtu siç punojmë për jetën e kësaj bote, duhet të punojmë edhe për jetën e ahiretit, e cila është e pafundme. Edhe një shtet i zakonshëm në botë, a nuk u jep dënim atyre që nuk i respektojnë rregullat, ashtu siç u jep shpërblim atyre që i respektojnë ata? Patjetër, që u jep. Këtë e

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

kërkon drejtësia. Pra, edhe Zoti jonë do t'i japë një shpërblim si xheneti, atyre që e besojnë Atë dhe i binden Atij. Gjithashtu, atyre që e kundërshtojnë Allahun, nuk i binden Pejgamberit (a.s.) dhe nuk pranojnë ato që ai ka sjellë, do t'u japë dënimin që meritojnë.

Krijimi për së dyti është më i lehtë se i pari


Zoti do t'i ringjalli sërish njerëzit pas vdekjes, me trupat e tyre. Kjo është shumë e lehtë për Atë. Allahu e ka krijuar çdo gjë me lehtësi nga hiçi. Krijimi për së dyti është më i lehtë se i pari. Ne e shohim dhe e pranojmë të parin, nëse themi që rikrijimi është i vështirë, do të thoshim diçka të palogjikshme. Këtë temë mund ta kuptojmë më mirë me një shembull të tillë:

Për shembull, që një drejtor shkollë ditën e parë të shkollës i ka ndarë në klasa lehtësisht mijëra nxënës dhe i ka caktuar atyre vendet dhe mësuesit. Ai ka përfunduar orarin e mësimeve dhe mësimet kanë filluar. Më pas ka rënë zilja e pushimit. Nxënësit, për pushim, ishin shpërndarë në çdo anë të shkollës. Tani, një person i cili e sheh që, drejtori e bëri me lehtësi organizimin e parë, a mund të thotë: “Drejtori nuk mund t'i mbledhë nxënësit me një tingull zileje, nuk e besoj pa e parë.”? Pa diskutim, nuk mund të thotë. A nuk do të ishte qesharake nëse do të thoshte?

Po, drejtori e ka krijuar rendin e shkollës nga hiçi dhe po i sjell vazhdimin. Një drejtor që e ka bërë me lehtësi këto, e ka shumë më të lehtë t'i mbledhë me një tingull zileje nxënësit që janë njohur më parë me njëri-tjetrin, që e kanë vendin të përcaktuar dhe që kanë hyrë në rregull më parë.

Në të njëjtën mënyrë, ringjallja e njerëzve do të jetë më e lehtë se krijimi i parë. Zoti i ka krijuar njerëzit nga hiçi, ashtu siç e përmendëm në shembull. Qelizat dhe organet e trupit tonë, janë prezantuar dhe kanë punuar së bashku gjatë jetës në këtë

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



botë. Qelizat kur të vdesin, do të shpërndahen për të pushuar. Zoti në Ditën e Ringjalljes qelizat e trupit tonë, që i ngjajnë nxënësve të shkollës të shpërndarë në vende të ndryshme, do t'i mbledhë me një tingull të fryrjes në sur nga ana e Israfilit. Kjo nuk është fare e vështirë për Allahun. Të gjitha qelizat do të ribashkohen në trupin ku kanë shërbyer në këtë botë. Më pas, Allahu do t'i kërkojë llogari njeriut për të gjitha veprat që ka bërë në dynja.

Po, kur e mendojmë, logjikisht krijimi i diçkaje për së dyti është më i lehtë se krijimi për herë të parë. Në historinë e njerëzimit, shpikja dhe bërja për herë të parë e një avioni, televizori dhe kompjuteri ka qenë e vështirë. Më vonë, është më e lehtë t'i mbledhësh dhe t'i ribashkosh pjesët e këtyre pajisjeve. Allahu, i cili i krijon njerëzit për herë të parë, nuk është i pafuqishëm t'i krijojë ata për së dyti.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Njerëzit i bëjnë zgjedhjet me vullnetin e tyre të lirë

Fëmijë të çmuar, dija e Zotit është e pafundme. Allahu di çdo gjë pa mangësi. Nuk ka rëndësi koha as vendi. Kader, do të thotë që, Allahu di çdo që që ka ndodhur në të shkuarën, çdo gjë që po ndodh në të tashmen dhe çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen.

Në gjërat që i ndodhin njerëzve ndikojnë dy lloj vullnetesh. I pari është vullneti i Allahut, me të cilin Allahu zgjedh me drejtësi cilësitë e robit të tij si: gjatësinë, ngjyrën, gjininë, atdheun, ku do të lindë, fëmija i kujt prind do të jetë. Njeriu nuk është i përgjegjshëm për këto gjëra. Ndërsa i dyti, nxënës të çmuar, është vullneti i lirë i njeriut. Pra, është liria për të bërë zgjedhje. Robi, me këtë vullnet zgjedh të bëjë hajër ose sherr, mirë ose keq. Njeriu, me këtë vullnet është krejtësisht i lirë. Nuk varet nga kaderi. Nëse njeriu do të ishte i varur nga kaderi, nuk do të lavdërohej dhe nuk do të shpërblehej për mirësitë që bën dhe nuk do të dënohej për ligësitë që bën.

Po, Allahu na ka dhënë të gjithëve një vullnet të lirë. Për këtë jemi të gjithë të ndërgjegjshëm. Njeriu kryen çdo veprim me vullnetin e tij. Duke qenë se Zoti di çdo gjë me dijen e Tij të pafundme, Ai i ka shkruar në kader zgjedhjet që bën njeriu me vullnet e tij. Kaderi shkruan çdo gjë duke e ditur se çfarë zgjedhje do të bëjmë. Pra, njeriu nuk i përjeton detyrimisht atë që i ka caktuar kaderi. Ne me vullnetin tonë të lirë zgjedhim të mësojmë ose jo. Zgjedhim të luajmë lojëra. Një nxënës që përumbet në lojë dhe nuk mëson e merr notë të ulët, nuk ka fare të drejtë të thotë: “Ky qenka kaderi im, ç’faj kam unë?”

Njerëzit janë përgjegjës për rezultatet e zgjedhjeve të tyre të lira. Për shembull, njeriu kur blen fruta në treg, i zgjedh ata me mendjen dhe vullnetin e tij. Frutat e kalbura dhe të shtypura

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



nuk i merr. Zgjedh ata që do. Ky veprim, është provë për të treguar se vullneti është i lirë. Kurse, nëse do të mbushte qesen rastësisht me fruta të kalbura dhe të shtypura, a do ta besonte njeri po të thoshte: “Çfarë të bëj, këtë kader kisha!”

Z. Jusuf e kishte mbaruar fjalimin e tij. E përfundoi fjalën duke thënë: “Ju falënderoj që më dëgjuat me vëmendje!” U ul në vendin e tij me duartrokkitje.

Fëmijët e kishin duartrokkitur mësuesin e tyre edhe më fort. Programi kishte qenë vërtet produktiv. Tani ishin afruar drejt fundit të programit. Prezantuesi falënderoi drejtuesit e universitetit dhe profesorët folës për organizimin e këtij programi të bukur.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Kur gjithçka e ka një qëllim, si mundet që njeriu të mos ketë!


Për të thënë fjalët përmbyllëse ftoi në skenë ndihmës rektorin e Universitetit të Islamit dhe Shkencave. Të gjithë nxënësit e duartrokitën ndihmës rektorin. Ndhmës rektori me një zë të emocionuar tha:

-Të dashur nxënës, dëgjuam prezantime shumë të dobishme nga profesorët tanë të nderuar. Të gjithë ju e ndoqët programin me interes. Ju falënderoj të gjithëve. Këtu, jeni ju ata që e meritojnë duartrokitjen. Ju jeni drita e shpresës së popullit tonë. Unë, i ftoj të gjithë ata që ndodhen këtu, t'ju duartrokasim juve, rininë tonë. Salla për një kohë, jehoi me duartrokitje. Ndhmës rektori, kur mbaruan duartrokitjet:

-Nxënës të dashur, për sa kohë ju do ta kuptoni dhe do ta jetoni fenë e bukur të Islamit, e cila është shpresa e njerëzimit, bota do të bëhet më e bukur. Njeriu besimtar, që e njej Zotin e tij dhe e di përse është dërguar në këtë botë, është një mundësi për njerëzit. Mendoni njëherë sahabet, të cilët i ka mësuar Profeti jonë (a.s.), i cili është udhëzuesi jonë. Ata, para se të besonin ishin mes paditurisë, zullumit dhe ligësisë. Pasi besuan, filluan t'i mësonin qytetërimin dhe njerëzimin vendeve më të qytetëruara. Ndërkohë që ishin në llahtari sa që vajzat e vogla i varrosnin të gjalla, me imanin dhe islamin u lartësuan sa që nuk lëndonin dot as një milingonë. Ajo çka i solli ata në këtë gjendje, ishte nuri (drita) e Profetit (a.s.).

Fëmijë të çmuar, të gjitha gjallesat e kanë një qëllim, për të cilin janë krijuar. Nga atomet deri në galaktikë, në një univers ku gjithçka e ka një qëllim, njeriu nuk mund të jetë pa asnjë qëllim. Kafshët si: pula, delja, keci, krimbi i mëndafshit janë krijuar për një qëllim. A mund të mendojë njeriu të jetë pa

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

asnjë qëllim, ndërkohë që përfiton nga rezultatet e punëve të tyre.

Njerëzimi që përdor mëndafshin e thurur prej një krimbi të vogël, nga gjethja e gjelbër e manit, duket ta njohë dhe ta dojë Allahun. Të gjitha krijesat të gjalla apo jo, i kryejnë të gjitha detyrat dhe funksionet në mënyrë të përkryer. Gjithashtu njeriu, duhet t'i kryejë të gjitha përgjegjësitë që i janë dhënë.

Ne të gjithë dërgohemi në këtë botë me shumë aftësi. Ndryshe nga gjallesat e tjera, ne lindim me aftësi të larta si mendja, logjika, tefekkuri, kurioziteti, habia, dashuria. Fakti që jemi krijuar me aftësi të tilla të pazakonta, tregon që jemi ndryshe nga kafshët. Dhe kjo gjendje është një provë konkrete që ne jemi dërguar në këtë botë për një qëllim të rëndësishëm.

Po të dashur nxënës, Allahu i Lavdëruar në ajetin e parë të Kuranit: “Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi!”⁴-thotë, duke urdhëruar që leximi të mos jetë në mënyrë të rastësishme. Ne sido që të lexojmë dhe çfarëdo që të lexojmë, duhet ta lexojmë me emrin e Allahut, për hir të Tij dhe pa e harruar Atë.

Ja që kur e shohim nga kjo anë fëmijë, universi është si libri më i denjë për t'u lexuar. Çdo shkencë na tregon artet dhe mrekullitë që Allahu ka krijuar në univers. Për këtë arsye ne, nuk duhet ta harrojmë zotëruesin e veprës ndërkohë që studiojmë veprën. Duhet ta njohim Zotin që nuk duket, me anë të imanit, duke u bazuar në veprat e dukshme. Në çdo gjë që është krijuar, duhet të mundohemi të shohim të gjithë emrat dhe mbiemrat si: ekzistencën, njëshmërinë, mëshirën, drejtësinë, bujarinë.

Nxënës, ju përshtendës të gjithëve me respekt dhe me dashuri, sa mirë që ju kam! Dua t'i përfundoj fjalët me një dua të Profetit (a.s.): “O Zoti ynë, na e vendos në zemër

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

imanin dhe na i zbukuro zemrat me iman. Mohimin, gjynahet, kundërshtimin na i trego të neveritshme. Na udhëzo neve në rrugën e atyre që e kanë gjetur rrugën e drejtë dhe prej të cilëve je i kënaqur!”

Çdo nxënës në sallon e shoqëroi këtë dua kuptimplotë duke thënë: “Amin, amin, një mijë herë amin!” Me këtë fjalim përmbyllës atmosfera ishte bërë edhe më e këndshme. Fëmijët po boshatisnin sallën një pjesë duke thënë: “Sa mirë që erdhëm!”, një pjesë duke vlerësuar fjalimet dhe folësit dhe disa të tjerë, duke bërë shaka me hare, thoshin: “Edhe unë dua të studioj në këtë universitet.” Programi kishte mbaruar dhe prezantimet kishin lënë mbresa të ëmbla në mendjet dhe zemrat e nxënësve.

Imani është pika jonë më e madhe e mbështetjes

Ditën e hënë ishin sërish në mësimin e z. Jusuf. Pas konferencës njerëzit e kishin kuptuar më mirë besimin në Allah.

Z. Jusuf:

-Nxënës të çmuar, të gjithë e ndoqët me shumë vëmendje konferencën që shkua në fundjavë, morët edhe shënime. Ju falënderoj të gjithëve. Shyqyr Zotit, ishte një konferencë me rezultate të mira.

Betyli:

-Ju falënderojmë ne juve, mësues. Sa mirë që na ftuat. Nëse nuk do të vija dhe do ta humbja këtë program do të mërzhitesha shumë. Gjithashtu, edhe nxënësit e tjerë: “Shumë faleminderit, mësues, rrofshi”-thanë.

Z. Jusuf pyeti:

TË SHOHESH PREJ MOLLËS



-Çfarë ju ka mbetur më shumë në mendje fëmijë?

⁴Surja Alak, ajeti 1.

Saiti kërkoi fjalë:

-Mësues, ishte hera e parë që hyja në universitet dhe dëgjova një konferencë nga profesorët e universitetit, në një sallë të madhe. Kjo ishte një eksperiencë e madhe për mua.

Ibrahimi:

-Mësues, edhe mua më pëlqyen shumë temat e konferencës. Ishin vërtet shumë të bukura.

Z. Jusuf:


-Po ti Ali Xhan?

-“Mësues, konferencën nuk e harroj dot, por as llokumet që hëngrëm në minibus nuk i harroj dot. Na çoni gjithmonë në konferenca të tilla.”-tha dhe të gjithë qeshën.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Dhe z. Jusuf pasi buzëqeshi:

-Fëmijë, programi ishte vërtet i dobishëm. Zgjoi një tjetër ndërgjegjësim tek të gjithë ne. E kuptuam edhe një herë vlerën dhe rëndësinë e imanit. Po, iman është një e vërtetë e fuqishme, me të cilën njeriu njeh Allahun dhe kupton që, asgjë në univers nuk bëhet rastësisht. E kupton që çdo gjë e krijuar është mrekulli e krijimit të Zotit. E di që të gjitha krijesat janë nëpunës në detyrë, të Allahut. Një njeriu me iman të tillë, ekzistenca e Allahut i jep siguri të plotë. Ai qetësohet me ekzistencën e Krijuesit të tij, i cili e sheh, e mëshiron gjatë gjithë kohës. Duke e ditur që, edhe krijesat e tjera të gjalla ose jo janë në detyrë, përpiqet të mos i dëmtojë ato. Imani, e shtyn atë të bëjë punë të mira dhe të dobishme. Hasani duke marrë leje:



-Mësues, ia tregova programin gjyshes time. Asaj i pëlqeu shumë. Gjyshja na tregoi neve fuqinë që imani i jep njeriut. “Njeriu, që ka iman, është i fortë dhe guximtar. Ne e kemi fituar Mallazgirtin, Dardanelet dhe Luftën e Shpëtimit me fuqinë e besimit.”-tha.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Zoti Jusuf:

-Gjyshja jote ka shumë të drejtë Hasan. Imani është pika jonë më e madhe e mbështetjes. Një njeri me iman të fortë çfarëdo që t'i ndodhë gjatë jetës i mbështetet fuqisë Allahut dhe i bën ballë çdo vështirësie me forcën e durimit, që i jep imani. Çfarë mund t'i bëjnë vështirësitë një personi që lidhet me fuqinë e Allahut me iman? Një mysliman me iman të fortë nuk dorëzohet para vështirësive, bën durim. Nuk e humbet shpresën, nuk bëhet pesimist sepse imani i tregon atij anën e mirë të çdo gjëje. E di shumë mirë që bota dhe çdo gjë që ndodh e ka një zotërues. Ai vepron me besimin se Allahu nuk do ta lërë kurrë vetëm. Bën të pamundurën për të arritur një qëllim ose për të shpëtuar nga një problem dhe më pas i dorëzohet Allahut.

Fëmijë, imani dhe guximi janë në përpjesëtim të drejtë. Pra, me rritjen e imanit rritet edhe guximi. Në histori, sa e sa ushtri të vogla kanë dalë fitimtare kundrejt sa e sa ushtrive të mëdha. Imani i jep njeriut këndvështrimin: “Nuk jemi vetëm, Allahu është me ne, mos hiq dorë nga të kërkuarit rrugëzgjdhje.” Një besimtari i qetësohet mendja, zemra, shpirti, ndjenjat sepse e di që, as edhe një gjethe nuk bie nga dega pa lejen e Allahut. Merr një kënaqësi të plotë nga jeta.

Saiti mori leje:


-Mësues, imani a nuk i jep njeriut edhe mundësi lutjeje?

Z. Jusuf, duke miratuar me kokë:

-E vërtetë, mundësia për të bërë dua është një mundësi e madhe. Ajo që na e mundëson këtë është besimi në Allah. Imani është pika jonë më e sigurtë e mbrojtjes. Ne hyjmë nën mbrojtjen e mëshirës së pafundme të Allahut, me dijeninë që

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

na jep imani. Një mysliman, i cili e di që çdo gjë ndodh me urdhrin e Allahut, fillimisht kërkon ndihmë nga Ai. I lutet Zotit. Me imanin kupton që është dikush, i cili dëgjon edhe dëshirat



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

më të fshehta që kalojnë në zemër. Dhe i përgjigjet lutjes së tij, sepse Atij i mjafton fuqia për çdo gjë. Thesari i pafundmë i mëshirës së Allahut i jep paqe dhe siguri besimtarit. Një njeri që ka fituar imanin, mund t'i lutet Zotit në çdo vend, në çdo kohë, në çdo gjendje. Duke qenë se Allahu nuk ka ndihmës dhe as ortak, mund t'i kërkojë Atij çdo dëshirë pa u ndeshur me asnjë pengesë. Mund të mbështetet në fuqinë e pafundme të Allahut dhe mund të hyjë nën mbrojtjen e mëshirës së Tij. Betyli që i kishte dëgjuar fjalimet me vëmendje, pyeti: “Mësues, pas konferencës ndjeva që mu shtua imani dhe më erdhi në mendje pyetja se si mund ta forcoj imanin?”

Z. Jusuf:

-Po, e prisja një pyetje të tillë. Në atë çast ra zilja. Z. Jusuf duke buzëqeshur: “Ah, kësmet! Mirë atëherë, në mësimin e radhës do të diskutojmë përgjigjen e kësaj pyetjeje së bukur. Mendoni dhe kërkonte edhe ju për pyetjen: ‘Si mund ta forcojmë imanin?’ Ju uroj të gjithëve ditën e mirë. Allahu ju ruajt!”-tha.

Si mund ta forcoj imanin tim?

Dita e mërkurë kishte ardhur. Z. Jusuf përshëndeti klasën si gjithmonë dhe i pyeti se si janë dhe a kanë ndonjë problem.

-Ejani pra, të flasim për pyetjen: ‘Si mund ta forcojmë imanin?’, siç e lamë mësimin e kaluar.

Nesibja:

-Unë pyeta babin për këtë temë. Babi: “Sportistët bëjnë ushtrime, punojnë dhe përpiqen për të zhvilluar muskujt. Kështu duhet që edhe ne myslimanët fillimisht të jemi në dijeni për zhvillimin e imanit dhe të punojmë për këtë. Njeriu

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

sa më shumë të lexojë libra rreth besimit dhe sa më shumë të mendojë e të flasë rreth tyre aq më shumë i rritet imani. Nëse ai e sheh çdo gjë si vepër arti, vë re edhe artistin. Ka dëshirë të njohë Allahun. Sa më shumë e njeh aq më shumë e do dhe sa më shumë e do aq më shumë ka dëshirë ta njohë Atë. Çdo tefekkur, i forcon njeriut lidhjen e imanit, që ka me Allahun.

Ibrahimi:

-Ndërsa unë pyeta xhaxhi Omerin, mësues. Më tha se adhurimet për Allahun dhe të qenit një rob i mirë i Tij mund të na e forcojnë imanin.

Z. Jusuf:

-Po, ju falënderoj. E vërtetë, ashtu siç tha xhaxhi Omeri, një tjetër mënyrë e rëndësishme për të forcuar imanin janë adhurimet. Një njeri që i kryen adhurimet e kupton që i gjithë universi është prona e Allahut. E kupton që nuk është pa qëllim këtu. Mëshira dhe Lavdia e Allahut zë vend në zemrën e tij, me namazin që fal dhe me adhurimet e tjera që kryen. Fëmijë, një tjetër pikë e rëndësishme është që njeriu, i cili i kryen adhurimet, vë re që edhe krijesat e tjera i kryejnë adhurimet. Sepse çdo gjë e krijuar e ka një qëllim krijimi. Për shembull delet janë krijuar për të dhënë qumësht dhe bletët për të dhënë mjaltë. Duhet patjetër që njeriu, i cili është krijuar me veçori më të larta nga të gjitha krijesat, të ketë një qëllim krijimi. Dhe, ky është besimi dhe adhurimi i Allahut. Fatkeqësisht, një njeri që nuk i kryen adhurimet nuk i sheh ose nuk i sheh dot adhurimet që krijesat e tjera i bëjnë Allahut. Namazet, adhurimet krijojnë një ndërgjegjësim të madh në lidhje me ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut.

Nxënës të dashur, adhurimet janë shkak i vendosjes dhe rënjosjes së imanit në zemrat tona. Për shembull Ibrahim,

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

supozojmë që ke në dorë një filiz dhe e mbjell, por nuk e ujit fare, a mund të rritet ai filiz?

Ibrahimi:

-Jo mësues, as nuk rritet e as nuk zhvillohet. Thahet.


Zoti Jusuf:

-Ja pra, kur nuk kryhen adhurimet imani dobësohet. Ndoshta nuk zhduket, por dobësohet. Për këtë arsye kryerja e adhurimeve është shumë e rëndësishme. Duatë, namazet janë nga elementët më të rëndësishëm që na vendosin dhe rrënjosin besimin në zemrat tona. Fëmijë të çmuar! Njeriu me adhurim, sidomos pesë herë në ditë namaze komunikon me Allahun dhe ndjen nevojën që ka për Atë. Të gjitha nevojat ia kërkon Atij. Kupton pafuqinë ndaj Allahut dhe me adhurim i mbështetet fuqisë së Tij të pafundme. Një njeri i tillë i bëhet rob Allahut me sinqeritet, duke qenë në dijeni të mangësive dhe gabimeve të tij, nëpërmjet ndërgjegjësimit që i jep imani. Nëse nuk i kryejmë adhurimet dhe e shkëpusim komunikimin me Allahun, Allahu na ruajt, atëherë bëhemi egoistë e zullumqarë.

Z. Jusuf duke iu drejtuar klasës pyeti: “A ka ndonjë tjetër që do të flasi për mënyrat e forcimit të imanit?”

Saiti duke kërkuar fjalën:

-Mësues, e pata lexuar në një libër. Thoshte që, mund të



TË SHOHESH PREJ MOLLËS

forcojmë imanin duke lexuar për jetët e pejgamberëve dhe të sahabeve, me në krye Profetin tonë (a.s.), dhe duke lexuar për mënyrat se si ata i bëjnë ballë vështirësive.

Zoti Jusuf:

-Bukur... Po, njerëzit janë dërguar në botë për një qëllim të shenjtë. Dhe udhëzuesit e parë të njerëzve janë pejgamberët. Pejgamberët, të cilët kanë jetuar para nesh dhe i kanë zbatuar



të gjithë urdhrat e Allahut , na forcojnë neve shpirtërisht. Veçanërisht, jeta shembullore e Të dërguarit tonë (a.s.), është një guidë e mrekullueshme për ne.

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

Profeti jonë (a.s.) i dashur, na ka mësuar neve gjërat që Zoti do që ne të bëjmë. Dhe bashkë me këtë, mënyrën se si duhet t'i bëjmë na e ka mësuar me shembullin e jetesës së tij.

Në veçanti, na ka treguar dhe shpjeguar arsyen pse nuk duhet t'i bëjmë gjërat që nuk duhen bërë. Gjithashtu ma ka mësuar se çfarë fitojmë nëse i zbatojmë urdhrat e Allahut dhe çfarë do të humbim nëse nuk i zbatojmë ato. Fillimisht, nxënësit e tij të parë, sahabet (shokët e tij), e ka në mësuar në mënyrë të përsosur mësimin e imanit. Përgjigjet e pyetjeve si: “Çfarë është imani? Çfarë është të duash Allahun? Si bëhesh një njeri i vërtetë? Si bëhet tefekkyr mbi veprat e Allahut? Si falënderohet Zoti për mirësitë? Si bëhesh rob i vërtetë i Allahut?”-i kanë mësuar nga Pejgamberi ynë (a.s.).

Z. Jusuf: “A ka dikush ndonjë mendim tjetër për këtë temë?”

Rejana:

-Mësues, a mund të bëj një pyetje?

-Patjetër, Rejanë, me kënaqësi!

-Forcimi i imanit, a mund të ketë lidhje edhe me një shoqëri të mirë?

-Po Rejanë. Bukur... Një shoqëri e mirë dhe tema të mira miqsh janë vërtet të rëndësishme. Nëse shoqëria i imponon të mirën, të bukurën një njeriu, ai do të jetë i prirë për të zgjedhur të mirën, të bukurën, të dobishmen. Shoqëria që zgjedhim, duhet të jetë një shoqëri që na afron me Allahun dhe pejgamberin. Njeriu mësimin e larë të imanit e merr nga familja, të afërmit dhe fqinjët. Nëna dhe babai bëhen mësues shpirtërorë për atë. Ata ia mësojnë imanin dhe Islamin fëmijëve të tyre duke e jetuar. Të afërmit, fqinjët bashkëpunojnë për të dërguar njëritjetrin në xhenet. Për këtë arsye, njeriu duhet ta njohë dhe ta

TË SHOHESH PREJ MOLLËS

zgjedhë shumë mirë shoqërinë e tij. Sepse shoqëria e keqe është faktori më i rëndësishëm që qëndron pas sjelljes dhe edukatës së gabuar, të cilat dëmtojnë sot mjedisin dhe shoqërinë.

Fëmijë të çmuar, imani, i cili do na çojë në xhenet, është vlera më e rëndësishme, të cilën nuk duhet ta humbasim kurrë. Kështu që, duhet të largohemi nga shoqëria e keqe që dëmton besimin dhe imanin tonë, siç largohemi prej gjarprit dhe akrepit. Duhet të kërkojmë shoqëri të dobishme që na shtyn neve drejt të mirës dhe të bukurës.

Dhe mësimi kishte mbaruar sërish me një tingull zileje. Z. Jusuf me një ton zëri të ëmbël: “Keni nevojë edhe për pushim fëmijë, atëherë shihemi në mësimin tjetër me një tjetër temë inshallah, Allahu ju ruajttë!”- tha dhe u nda nga klasa duke buzëqeshur.